

ANASh

APPROACHING SCIENCE

ANALET
E ALB-SHKENCËS
Viti II, Numri 4,
Dhjetor 2007

Botim i Institutit Alb-Shkenca
(www.alb-shkenca.org)

Atë Gjergj Guxeta në albanologjinë shqiptare
Prof. BARDHYL DEMIRAJ

Nanoteknologjia dhe çmimet Nobel 2007
Prof. Dr. JAHJA KOKAJ

Për një kushtetutë shqiptare
Av. AGRON ALIBALI

Parashikimi i shpërndarjes së lagështisë së tokës
ZAMIR LIBOHOVA

Temporaliteti i poemës së Gavril Darës së Ri
Prof. ZEQRJA NEZIRI

In Memoriam: Profesor Remzi Bakalli
Dr. BAJRAM BERISHA



Botimi i një **reviste informativo-shkencore shiptare** u bë i domosdoshëm në kushtet në të cilat ndodhet dhe zhvillohet sot shkenca në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni dhe në një kohë kur numri i anëtarëve të Forumit Alb-Shkenca (<http://www.alb-net.com/mailman/listinfo/alb-shkenca>) ka arritur një numër të madh pjestarësh. Shumica e këtyre anëtarëve janë studiues, pedagogë e studentë pasuniversitarë shqiptarë që kryejnë veprimtarinë e tyre shkencor në vende të ndryshëm të botës. Por ka edhe shumë anëtarë të Alb-Shkencës që kontribuojnë në gjallërimin e jetës shkencore në universitetet dhe institucionet shkencore në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Revista e Alb-Shkencës synon të bëjë të njohur në të gjithë botën shqiptare aktivitetin shkencor mjaft të larmishëm dhe shpesh herë shumë cilësor, të studiuesve shqiptarë kudo që ndodhen në botë. Nëpërmjet përzgjedhjes së kujdesshme të shkrimeve, në këtë revistë kemi pranuar për botim vetëm ato shkrime që kalojnë në nanofiltrin e cilësisë. Këtu pra do të pasqyrohet ajo ç'ka është më e shquara e kontributit shkencor shqiptar në këto vite të para të shekullit XXI.

Kjo revistë e përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse, botim i **Institutit Alb-Shkenca** (www.alb-shkenca.org), është menduar t'i shërbejë një auditori të gjerë intelektualësh e dashamirësish të shkencës në përgjithësi dhe të shkencës shqiptare në veçanti. Anëtarët aktualë të Institutit vendosën ta quanin këtë revistë me emrin simbolik: **ANASH—Approaching Science**.

Dikush mund të pyesë: Përse emri ANASH? Ai është akronim i emrit “Analet e Alb-Shkencës” që është edhe emri zyrtar i kësaj reviste. Por fjala shqip “anash” merr një kuptim simbolik fare të veçantë kur vendoset përpara shprehjes në anglisht “Approaching Science”.

Fjala “anash” ka edhe një kuptim të dytë simbolik që reflekton të vërtetën, atë që diaspora intelektuale e shkencore shqiptare është lënë pakëz mënjanë nga vëmendja e politikëbërësve dhe pushtetarëve shqiptarë e ndoshta edhe është harruar për shkak të largësisë e kohës nga trojet e atdheut.

Por e vërteta është që edhe pse ndodhen larg, anash realitetit të përditshëm të shqiptarëve të Ballkanit, intelektualët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë atdheut shërbejnë jo vetëm si **ambasadorë** të shkëlqyer por vëzhgojnë e ndjekin nga afër ecuritë në çdo fushë të jetës dhe shoqërisë shqiptare. Të organizuar tek Alb-Shkenca ata gjithmonë e më shumë po kërkojnë të marrin pjesë aktivisht dhe të ndihmojnë për një jetë më të mirë të shqiptarëve kudo që ndodhen. Botimi i revistës ANASH është shprehje e qartë e këtij angazhimi serioz të **diasporës shkencore** që po përpikët përditë e më tepër të kontribuojë në zhvillimet jo vetëm të shkencës dhe arsimit por edhe të shoqërisë shqiptare në përgjithësi.

Revista ANASH-it përfshin një larmi artikujsh prej fushave nga më të ndryshmet shkencore të përgatitur nga studiues të afirmuar apo studentë pasuniversitarë shqiptarë që kontribuojnë në shkencën botërore edhe në disiplinën shkencore nga më të rejtat si nanoteknologjia, ekologjia dhe informatika, por edhe në fushat klasike të shkencës si fizika, veterinaria, ekonomia dhe gjuhësia (albanologjia).

Ju urojmë të gjithëve lexim të këndshëm.

Redaktor përgjegjës: **Roland Leli**, Toronto, Kanada
Adminstratore e përgjithshme: **Lindita Komani**, Grac, Austri
Redaktorë shkencorë: **Robert T. Magari**, Ph.D., Florida, SHBA
Nikolla P. Qafoku, Ph.D., Richland, SHBA

KUJTESË PËR SHKRIMET DHE AUTORËT NË “ANASH”

Në revistën *ANASH-Approaching Science* (Analet e Alb-Shkencës) të përgatitur nga Instituti “Alb-Shkenca” kryesisht botohen: i) raporte shkencore; ii) komente; iii) perspektiva; iv) prezantime apo përmbledhje diskutimesh në konferenca; v) letra që mund t'i dërgohen botuesit të *Analeve*. Botohen gjithashtu edhe shkrime të cilat mbështeten apo marrin ide nga diskutimet që bëhen në Forumin tonë “Alb-Shkenca”.

i) Raportet shkencore përmbajnë rezultate origjinale të punës shkencore të autorit apo autorëve. Duhet të jenë 4-5 faqe të gjata përfshirë këtu fotot ilustruese dhe referencat bibliografike.

ii) Komentet mund të shkruhen për artikuj të një rëndësie të veçantë në një degë përkatëse shkencore apo edhe për libra shkencorë. Ata duhet të jenë jo më të gjatë se 3 faqe.

iii) Perspektivat paraqesin ide rreth kërkimit shkencor në fusha të veçanta studimi. Ato duhet të jenë 1-3 faqe të gjata.

iv) Prezantimet në konferenca mund të paraqiten si përmbledhje të rezultateve dhe rekomandimeve më kryesore, ku mund të përfshihen jo më tepër se 1-2 foto. Ato duhet të jenë 1-2 faqe të gjatë.

v) Letrat për botuesin duhet të jenë të gjata 1-1,5 faqe dhe do të trajtojnë probleme nga më të ndryshmet që kanë të bëjnë me kërkimin shkencor.

ANASH është një revistë e përgjithshme shkencore me një auditor të gjerë lexuesish që i takojnë fushave të ndryshme. Për këtë arsye, dorëshkrimet që do të dërgohen për botim duhet të jenë të kuptueshme për këtë auditor. Dorëshkrimet do të pranohen në shqip dhe anglisht në adresën: **anash@alb-shkenca.org**. Ato duhet të shtypen në “word” me hapësirë dyfish ndërmjet rreshtave si dhe me madhësi gërmash 11 pt.

Pasi merren në redaksi, dorëshkrimet u dërgohen 1-2 recensuesve, njeri prej të cilëve është anëtar i Institutit “Alb-Shkenca”. Procesi eshte i tillë që recensuesit nuk njohin emrin apo emrat e autorëve, dhe po ashtu, autorët nuk dinë emrat e recensuesve. Dorëshkrimi do t'i kthehet mbrapsht autorit për të reflektuar vërejtjet e rastit e autori do të duhet të ridërgojë në redaksi dorëshkrimin e korrigjuar pas një periudhe jo më të gjatë se 2 javë nga dita që e ka marrë nga redaksia. Çdo komunikim ndërmjet redaksisë, autorëve dhe recensuesve do të bëhet elektronikisht. Këtij procesi nuk do t'i nënshtrohen dorëshkrimet, të cilët u kërkojnë autorëve nga këshilli botues i revistës. Në këtë rast, njëri prej anëtarëve të Këshillit Botues do ta lexojë dorëshkrimin dhe do t'i dërgojë vërejtjet autorit.

Revista botohet në formë elektronike dhe mund të lexohet në faqen e Institutit “Alb-Shkenca” në internet në adresën **www.alb-shkenca.org**. Për mundësinë e shtypjes së saj dhe për çmimin do të vendoset në vijim.

Pyetjet dhe sugjerimet tuaja mund t'i drejtoni në adresën **anash@alb-shkenca.org**.

PASQYRA E LËNDËS


- 4 Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi klimën, Bali 2007
- 5 Aspekte të mendimit intelektual shqiptar në shek. XVIII-të.
Atë Gjergj Guxeta dhe vendi i tij në historinë e albanologjisë
PROF. BARDHYL DEMIRAJ
- 12 Toka jonë është vënë në lojë **SYDNEY ALTMAN**
(Përshtatur nga "Corriere della Sera - Scienze e Tecnologie")
- 13 Nanoteknologjia dhe çmimet Nobel 2007
PROF. DR. JAHJA KOKAJ
- 17 Për një kushtetutë shqiptare **AV. AGRON ALIBALI**
- 19 The Prediction of Soil Moisture Distribution for a Small
Catchment by the Distributed Hydrology Soil Vegetation Model
(DHSVM) **ZAMIR LIBOHOVA**
- 25 Temporaliteti i poemës së Gavril Darës së Ri
PROF. DR. ZEQIRJA NEZIRI
- 33 In memoriam: U nda nga jeta Prof. Dr. Remzi Bakalli
DR. BAJRAM BERISHA
- 35 Punimet shkencore të anëtarëve të Alb-Shkencës, 2007
- 43 Këndi i librit

TAKIMI I TRETË I ALB-SHKENCËS, TIRANË, SHTATOR 2007

Këto ditë kemi filluar përpjekjet për organizimin e takimit të ardhshëm të Alb-Shkencës, i cili është i treti i radhës, pas takimit të dytë të suksesshëm të zhvilluar në Prishtinë vitin e kaluar. Për vitin 2008 kemi menduar që takimi i 3-të të mbahet në Tiranë në fillim të muajit shtator.

Ftojme pra të gjithë anëtarët e Institutit Alb-Shkenca, anëtarë të Forumit tonë dhe gjithë punonjësit shkencorë nga trojet shqiptare dhe nga diaspora që të na njoftojnë për dëshirën dhe gatishmërinë për të marrë pjesë në këtë takim. Në adresën e Grupit Administrues ga@alb-shkenca.org, mund të na dërgoni temat të cilat ju mendeni të paraqisni në këtë takim dhe mundësinë tuaj për të kontribuar në mbarëvajtjen e punimeve të konferencave shkencore që do të organizohen në këtë kuadër.

Universiteti Politeknik i Tiranës
(Foto: Udhetimi.com)



BALI,
DHJETOR
2007

Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi klimën

Përmbledhi Roland Leli

Më 3 dhjetor 2007 u hap në Bali (Indonezi), Konferenca e 13-të e Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimin e klimës.

(UN Framework Convention on Climate Change - UNFCCC). Takimi u hap me shpresat më të mira kur delegacioni australian i kryeministrit të ri Kevin Rudd deklaroi se Kanberra do të ratifikonte Protokollin e Kiotos (1997), akordi ndërkombëtar që caktoi objektivat për të ulur çlirimin e gazrave serrë në vendet e zhvilluara.

Megjithatë, konferenca e gjatë e Balit u karakterizua nga tensionet midis Shteteve të Bashkuara (vendi i parë në botë për prodhimin e gazrave serrë) dhe aleatëve të tyre nga njëra anë dhe Europës e mbështetësit e saj nga ana tjetër. Pasi kaloi dita e caktuar për firmosjen e një marrëveshjeje, takimi u duk sikur po mbyllej në mënyrën më të padëshiruar. Pas diskutimeve të gjata, 190 vendet pjesëmarrëse aprovuan dokumentin e pagëzuar "Bali roadmap" që i hap rrugën një traktatit dy vjeçarë e cila do të mbyllet me takimin e Kopenhagenit më 2009.

Megjithë firmosjen e dokumentit rezultati i vetëm real i konferencës ishte ai i projektit pilot për të shpjeguar se si mund të ndalet shpyllëzimi barbar i

pyjeve tropikale.

E reja e konferencës së Balit është se edhe vendet në zhvillim, që nuk kanë ndonjë detyrim nga Protokollin e Kiotos, pranuan që të ndërmarrin "masat e duhura" për reduktimin e gazrave serrë duke marrë në shkëmbim teknologji moderne dhe financime nga vendet e industrializuara. Në të njëjtën kohë, pozicioni i vendeve të zhvilluara në një farë mënyre u ëmbëlsua me premtime për "veprime konkrete" që janë "të përshtashme për secilin shtet duke mbajtur parasysh rrethanat kombëtare".

Kjo është pak a shumë ajo që donte edhe administrata amerikane, protagonistet negative e këtij takimi për opozitën e vazhdueshme ndaj projekteve ambicioze të Komunitetit Europian.

Me pak fjalë ecuria e konferencës: India qysh në fillim propozon një korrigjim të tekstit final. Amerika kundërshton me forcë. Muri përballë murit vazhdon ditë të tëra dhe rrezikon që konferenca të dështojë. Në këtë moment, sekretari i përgjithshëm Ban-ki Moon iu kërkon të gjithë delegatëve që "të tregojnë një ndjenjë përgjegjësie. Bota po na sheh dhe pret nga ne." Pas tij, Yvo de Boer, sek-

retar ekzekutiv i UNFCCC (organizëm i OKB-së që drejton Protokollin e Kiotos) për shkak të tensionit të lartë braktis sallën në mënyrë demonstrative nën shikimin e habitur të pjesëmarrësve të shumtë. Kjo skenë, në të vërtetë pakëz teatrale, ndoshta ndikoi për të çbllokuar gjithë situatën. Pikërisht atëherë kur dukej sikur gjithçka mori të tatëpjetën e pashpresë, Shtetet e Bashkuara tërhiqen nga pozita e tyre kundërshtarë. Propozimi indian pranohet dhe "Bali roadmap" i dorëzohet historisë nën duartrokitjet çliruese të assemblesë.

Por, kohët do të jenë të gjata. Të gjitha vendet do të fillojnë traktativat për të vendosur, brenda vitit 2009, mbi sasinë e gazit karbonik që duhet reduktuar duke filluar nga viti 2012, kur skadon Protokollin e Kiotos. Në vitin 2009, siç kujtoi edhe Al Gore, SHBA-ja (që në "Bali roadmap" refuzoi të japë shifra e përqindje mbi reduktimin e gazrave serrë) do të ketë një president të ri e mendohet që të jetë me një qëndrim më të butë e bashkëpunues edhe në çështjet e klimës.

Deri atëherë rruga që çon nga Bali në Kopenhagen do të jetë ende e gjatë, e vështirë e me pengesa.

Aspekte të mendimit intelektual shqiptar në shek. XVIII Atë Gjergj Guxeta dhe vendi i tij në historinë e albanologjisë

“Ujët shkon e zalli rri.”

Shfrytëzoj rastin të përmend që në hyrje të këtij punimi të thukët¹ mendimin e shfaqur shpesh kohët e fundit lidhur me (ri)vlerësimin kritik të disa figurave që i kanë dhënë tonin zhvillimit të debatit albanologjik përgjatë shek. XVIII. Është kjo një periudhë që jemi mësuar ta damkosim jo rrallë, por patëkeq, si parashkencore, edhe pse jemi më se të vetëdijshëm se kjo është pikërisht periudha, kur u hodhën bazat e atyre disiplinave që formëzojnë sot së bashku fushën komplekse të albanologjisë.

Sa i përket rivlerësimit të personalitetit të Atë Gjergj Guxetës, duam të theksojmë që në fillim se bëhet fjalë këtu për një shqyrtim të detajuar të trashëgimisë së tij intelektuale, e cila po përvijon dita me ditë konture të plota, falë zbulimit fatlum të veprës së tij në dorëshkrim De Albanesium Italiae ritibus excolendis, vepër e cila gëzoi këtë vit dritën e botimit, duke u bërë kështu pronë e një rrethi shumë më të zgjeruar lexuesish. Përndryshe njohja po aq fatlume dhe botimi apo ribotimi i veprave të tjera të kësaj periudhe, që na kanë lënë kryesisht në dorëshkrim ish-nxënës apo ithtarë të tij të mëvonshëm, lejojnë të bëhen përsiatje të sakta lidhur me rolin që luajti kjo trashëgimi në mbarëvajtjen e filologjisë italo-arbëreshe në përgjithësi e të asaj të zhvilluar në Seminarin Arbëresh të Palermos në veçanti.

Ç’vend zë Guxeta në historinë e albanologjisë? – një pyetje kjo që vjen më se natyrshëm, po të marrim në analizë zhvillimet që përjetoi filologjia italo-arbëreshe përgjatë shek. XVIII. Dhe studimet paraprake në këtë drejtim nuk është se mungojnë. Mjafton të përmend këtu punimet e fundit të dy kolegëve dhe miqve të mi prof. Mandala dhe Altimari, në të cilat sendërtohet bindshëm mendimi se filologjia italo-arbëreshe përjetoi një “kthesë vendimtare [...] në vitet 30-të të shek. XVIII, kur u themelua në Shën Benedikt në Kalabri, Kolegji Corsini (1732) dhe në Palermo Seminari Arbëresh (1734)” (Mandalà 2006:11). Pikërisht këtë “kthesë vendimtare” jam përpjekur ta bëj objekt diskutimi në punimin tim, duke e vështruar atë nga dy perspektiva

studimi: a) në kuadrin e aktivitetit intelektual dhe social të vetë Guxetës; si edhe b) në përjasje me nivelin e debatit albanologjik në Evropën e asaj kohe. Sigurisht që për të arritur në ndonjë rezultat paraprak është e nevojshme t’i përmbahemi skemës së thjeshtë e të përgjithshme të zhvillimit të një discipline shkencore çfarëdo, e cila parakupton fillimisht, krahas objektit edhe a)

shfaqjen/lindjen e ideve që hedhin dritë në enigmat që fshihen në të; duke vijuar më pas b) përpilimin e një metode që mundëson mbledhjen, organizimin dhe hulumtimin e materialit (p.sh. gjuhësor) nga një këndvështrim i ri; si edhe c) përgatitjen dhe formimin adeptëve, që e thellojnë më tej atë hulli studimi; çka siguron d) vazhdimësinë e nevojshme në hulumtim, e që gjen shprehjen në përfundimin e qendrave kërkimore, përkatësisht në zhvillimin e një infrastrukture ndërinstitutionale e kolegjiale për disiplinën a disiplinat në fjalë.

1. Guxeta si ideator dhe themelues i qendrës së parë dhe më të vjetër albanologjike

Duke iu përmbajtur kësaj skeme, vërejmë se themelimi i dy kolegjeve të lartpërmendura krijoi pa dyshim kushte më se të favorshme si për përgatitjen dhe formimin e adeptëve, ashtu edhe për sigurimin e një rrjedhe normale të studimit historik dhe filologjik në arealin kulturor arbëresh. E në rast se lejohej të flasim sot për një vatër të mirëfilltë studimesh albanologjike në këtë periudhë, këtë mund ta mëtojmë pa drojë të paktën për Seminarin



Atë Gjergj Guxeta (1682-1756)

1. Ky punim është botuar në formë të plotë në “Hylli i Dritës” 3 [2007] 9-26.

Arbëresh të Palermos, i cili u ngjiz dhe funksionoi që në fillimet e tij edhe si një qendër e filologjisë italo-arbëreshe dhe e albanologjisë në përgjithësi. Kështu, mjafton të sjellim për ilustrim këtu krahas emrit të ideatorit dhe themeluesit të tij, Atë Gjergj Guxetës, emrat e një aradhe të tërë adeptësh, ithtarësh dhe kolegësh të tij, që u morën intensivisht me kërkime në fushat e historisë, kulturës e të filologjisë arbëreshe, si p.sh.: Pal Maria Prifti (/Parrini), Nikollë Filia, Nikollë Keta në shek. XVIII; Sepë Krispi në shek. XIX apo Pal Skiro në fillim të shek. XX.

Faktësisht gjithashtu që përgjatë shek. XVIII nuk ndeshim kurrkund në Evropë dhe Ballkan ndonjë qendër simotër të studimeve albanologjike, e cila do të mund të konkurronte deri diku Seminarin Arbëresh të Palermos në shumësinë dhe larminë e aktiviteteve intelektuale e sociale. Kështu p.sh. në hapësirën kompakte kulturore-etnike shqiptare në perëndim të Ballkanit përjetojmë përçapjet e para drejt një qendre filologjike aty rreth gjysmës së dytë së atij shekulli në akademinë e Voskopojës, ku shqipja shërbeu gjithsesi thjesht dhe vetëm si mjet ndihmës për përvetësimin më të mirë të greqishtes nga ana e shqipfolësve; ndërsa në arealin kulturor-katolik të Veriut – krahas ndonjë shkolle të improvizuar për fillestarë, ku mësohej katekizmi edhe në gjuhën shqipe – hasim vetëm ndërmarrje individuale, siç është p.sh. rasti i Imzot Gjon P. Nikollë Kazazit, i cili njihet tashmë në historinë e albanologjisë si autori i një doktrine të vogël shqip (Romë 1743) e në të njëjtën kohë – falë korrespondencës që mbante me Atë Gjergj Guxetën – edhe si njëri ndër zbuluesit e “Mesharit” të Gjon Buzikut.

Ndërmarrje kryesisht të izoluar i hetojmë në këtë qindvjetësh edhe në perëndim të Evropës. I tillë është p.sh. debati albanologjik që u zhvillua në hapësirën kulturore gjermanishtfolëse, kur filozofi dhe enciklopedisti gjerman Gottfried Wilhelm v. Leibniz (në korrespondencën e tij gjatë viteve 1688-1714) u interesua dhe fitoi njohuritë e para mbi gjuhën shqipe për të mëtuar më pas edhe origjinën e saj prej ilirishtes; ose aty rreth 60 vjet më vonë historiani suedez i universitetit të Halle-s Johann Thunmann (1774), i cili iu përkushtua me intensitet çështjes së origjinës së shqiptarëve, duke i parë ata gjithashtu si pasardhës të drejtpërdrejtë të fiseve ilire në Ballkanin antik.

2. Vepra e Guxetës si program i filologjisë arbëreshe në shek. XVIII

“Kthesën vendimtare” që cituam më lart e përcjellim po aq bindshëm në paletën programatike dhe në metodën e studimit që orientoi debatin albanologjik në arealin kulturor italo-arbëresh. Me njohuritë që kemi sot në dispozicion, përkatësisht me vendosjen e tyre në aksin kronologjik, rezulton të ketë pasur përsëri rolin e udhërrëfyesit apostulli ynë, ashtu siç na prezantohet në vepër të tij në dorëshkrim (Mandalà 2006, 14vv.).

Është bash ky doracak i papërfunduar, ku ngërthehen për herë të parë e në mënyrë ballore të gjithë ata faktorë që kushtëzojnë së bashku dhe i japin formë të ashtuquajturit matriks të kulturës etnike arbëreshe, si p.sh.: a) momenti historik i zhvendosjes së bashkësisë etnike arbëreshe drejt brigjeve perëndimore të Jonit dhe Adriatikut; përkatësisht hapësira etnike kompakte e dikurshme në Ballkanin perëndimor (Cap. Primo), b) mënyra e jetesës, botëkuptimi dhe kultura materiale në traditën popullore arbëreshe (Cap. Secondo), sikurse edhe c) gjuha (Cap. Terzo); dhe d) riti e besimi fetar (Cap. Quarto e Quinto).

Interes të veçantë fiton në vepër mënyra se si i kombinon Guxeta këta faktorë, si edhe metoda që ai zbaton, kur trajton një çështje të tillë, si p.sh. ajo e identitetit etnik-kulturor të arbëreshëve të Italisë. Jo më pak i rëndësishëm është edhe qëndrimi i tij ndaj gjuhës, jo vetëm si komponent themelor i kulturës etnike, por edhe si çelës metodik në shqyrtimin e problemit kompleks të etnogjenezës shqiptare. Andaj le të përqendrohemi në vazhdim kryesisht me analizat dhe rezultatet që arrin Guxeta gjatë trajtimit të këtij problemi, duke ndërmarrë sipas rastit përjasjet përkatëse edhe me rezultatet e debatit albanologjik në arealet të tjerë kulturorë në Evropën e asaj kohe.

2.1 Çështja e identitetit etnik-kulturor italo-arbëresh

Sa i përket çështjes së identitetit italo-arbëresh, do shtuar që në fillim se ajo ishte rrjedhojë e natyrshme e konfrontimit të vazhdueshëm ndërkonfesional në shtresat e klerit bashkëkohor (Bartl 1969 32vv.; Mandalà 2006 18vv.), meqë në ngulimet arbëreshe vijonte të ushtrohej sikurse dikur në trojet e tyre etnike në Ballkan riti ortodoks bizantin, ndërkohë që në mjedisin e ri social-kulturor mbizotëronte riti katolik romak. Në këtë kuadër arbëreshët konsideroheshin, madje edhe përçmoheshin atëbotë si grekë (ortodoksë), d.m.th. skizmatikë. Meritë e pakontestueshme e Guxetës është që ai këtë çështje e ngre në nivelin e një debati të mirëfilltë intelektual, duke e vështruar konfesionin fetar thjesht dhe vetëm si njërin ndër komponentët përbërës të atij qerthulli problematik që ngërthehte identiteti etnik-kulturor i arbëreshëve.

Poashtu, Guxeta pjesëmerr në mënyrë sa aktive aq edhe konfrontative në debat, duke vënë përballë njëra-tjetrës dy teza diametralisht të kundërta: a) e para, siç e pamë më sipër, kish të bënte me mendimin, pas gjase gjerësisht të përhapur aso kohe në rrethet intelektuale e fetare të Italisë (së Jugut), sipas të cilit italo-arbëreshët janë grekë; ndërsa b) e dyta është teza që mbështet vetë Guxeta, e cila parakupton si të mirëqena marrëdhëniet e drejtpërdrejta të filiacionit ndërmjet arbëreshëve të Italisë dhe popujve jogrekë që gjëllinin në pjesën perëndimore të Ballkanit antik, të cilët – sipas tij – nuk mund të ishin tjetër

veçse maqedonasit dhe epirotët e dikurshëm.

Prima di tutto bisogna confutare la diffusa opinione di coloro che confondono questa gente con quella greca. Di certo gli Albanesi non sono greci, infatti traggono la loro origine, non dai Greci, ma dagli Epiroti e dai Macedoni. (De albanesium, Cap. Primo)

Gjithsesi Guxeta nuk mungon të shtojë që në rrjedhë të kohës, sidomos pas ngërthimit të këtij territori në perandorinë romake, u përfatuan përzierje me racën (= gjakun) romake dhe romane, nga e cila rezultojnë sot maqedonasit modernë apo arbëreshët.

Sicuramente il sangue latino si diffuse nelle varie parti dell'Albania abbastanza bene e i costumi splendidamente fiorirono sotto i principi cristiani. [Si dice che] Teodosio, imperatore d'Oriente, portò dalla Spagna un gran numero di suoi amici e familiari per governare varie città e genti dell'Albania. È sicuro che fino ai tempi del principe Kastrioti in Albania erano famose le più nobili famiglie di Spagnoli, detti albano-spagnoli, e invincibile Eroe li ebbe come compagni valorosissimi e fedelissimi contro i turchi. Come è sicuro che tra i siculi albanesi nostrani, fino a questo momento, si trovano alcune famiglie spagnole. (De albanesium, Cap. Sec.)

Përballja e këtyre dy tezave përshkon fund e krye gjithë veprën, duke kushtëzuar deri diku edhe organizimin e argumenteve pro dhe kundër, në kuptimin që ato argumente negative, të cilat kundërshtojnë bindshëm pseudo-tezën mbi origjinën greke të italo-arbëreshëve, Guxeta i përcjell në të njëjtën kohë si argumente pozitive që tumirin tezën mbi origjinën maqedonase të italo-arbëreshëve. Ndër to përmendim:

a) Argumenti gjeografik-historik

Sipas Guxetës arbëreshët në Sicili dhe gjetkë në Italinë e Jugut nuk janë anas në ato troje. Si moment historik që nxiti eksodin tragjik të arbëreshëve drejt brigjeve Italisë ai cilëson vdekjen e heroit legjendar Gjergj Kastrioti – Skënderbeu në shek. XV, një ngjarje kjo e hidhur që do të mund të sillte pasoja të pallogaritshme ndaj gjithë popullsisë shqiptare të krishterë, e cila gjëllinte atëbotë në Shqipërinë e pushtuar prej osmanëve. Sipas tij:

Gli albanesi costituiscono una parte, non esigua né di poco conto, del gregge di Cristo; essi vivono in Italia sparsi qua e là nelle diverse colonie. Li cacciò via dall'Epiro la furia dei turchi, dopo che Giorgio Kastrioti Skanderbeg (a cui va somma lode), il principe più cristiano di tutta l'Albania, morì liberandoli dall'eterno terrore di costoro: grazie alla pietà dei re di Spagna e all'amicizia verso il defunto principe, essi furono accolti nei regni di Sicilia, Calabria e Puglia; e grazie allo zelo della Santa Chiesa

di Roma essi furono affidati ai vari ordinamenti, sotto la protezione dei vescovi locali, per essere aiutati nel migliore dei modi. (De albanesium, Cap. Sec.)

Përndryshe, atdheu origjinar i arbëreshëve shtrihej atëbotë sikurse edhe në antikitet në Ballkanin perëndimor, në veri të hapësirës jetike greke, pikërisht në trojet e fiseve të dikurshme maqedonase dhe epirote.

Sicuramente la parte occidentale della Macedonia e, un tempo, tutto l'Epiro, ora quella parte, che, confinante con la Macedonia a nord, si protende a ovest fino ai monti Acrocerauni, che sovrastano il mare Adriatico, formano in parti uguali l'Albania. Né i Macedoni o gli Epiroti sono Greci, ma dominatori dei greci, creatori dell'impero greco, principi, per cui furono detti greci, come i greci stessi dopo che l'impero Romano per iniziativa di Costantino Flaviano Augusto fu trasferito in Grecia, si vantarono di essere chiamati Romani. (De albanesium, Cap. Sec.)

b) Argumenti etnografik

Botëkuptimi dhe tradita jetësore të shqiptarët janë – sipas Guxetës – krejt të ndryshme nga ato të grekëve. Kështu:

Quanto al resto, tuttavia, gli Albanesi non sono Greci anche se hanno in comune con i Greci i santissimi riti, non la lingua, non l'amore per la vita, non i comportamenti umani, infine non la stessa foggia dell'abito che in particolare le donne albanesi mantengono fino a questo momento in territorio italiano. (De albanesium, Cap. Sec.)

Për Guxetën arbëreshët “non hanno nulla in comune con i greci sia nel modo di vivere sia nel modo di vestirsi”. Për më tepër :

La gente albanese infatti sembra nata unicamente [...] non per le lettere (letteratura), ma per usare le armi e per fare guerra, cosa che sotto Pirro, Alessandro Magno e poi sotto il Principe Skanderbeg [...] I soldati albanesi deridono la gente greca effeminata, parlano male dei suoi costumi; ma questa (fama), gonfiata finora da antiche e molteplici notizie, taccia gli albanesi di nullità e ovunque li fa chiamare rudi e illetterati. (De albanesium, Cap. Sec.)

duke vazhduar më pas:

Dunque in questi, e cosa ancora più grave, anche negli animi, essi discordano molto dai greci e per dirla con una sola parola: grande è l'odio, direi quasi, e naturale l'antipatia degli Albanesi verso i Greci. Per cui sono abituali, presso l'una e l'altra gente, quei vergognosi proverbi* e quegli sciocchi insulti con i quali si colpiscono a vicenda. (De albanesium, Cap. Sec.)

c) Argumenti kulturor-historik

Megjithatë – shton Guxeta – arbëreshët nuk kanë munguar asesi të nxjerrin atëbotë edhe ndonjë pinjoll bëmëmadh në punë të letrave, siç është p.sh. rasti i Aristotelit:

A liberarli da questo offesa bastò lo Stagirita (= Aristoteles) principe dei filosofi, l'unico tra gli altri albanesi che si dedicarono alle lettere anche in mezzo alle armi. (De albanesium, Cap. Sec.)

Gjithsesi ajo mënyrë jetese e sidomos mungesa e trashëgimisë shkrimore në gjuhën amtare – sipas Guxetës – kanë ndikuar negativisht në rrëgjimin e traditës dhe të kujtesës historike të shqiptarët. Kështu:

D'altronde della sua antichità non possono essere sufficienti i ricordi, seppur abbastanza chiari. Infatti i macedoni non ebbero la possibilità di avere lettere (alfabeto) proprie per questa lingua, adattata solo all'uso del popolo, e non consegnarono nulla alle posterità (ai posteri) se non in lettere greche e in una lingua in cui abbiamo visto coniate in greco le monete di Pirro, di Alessandro e dei precedenti re delle Macedonia e dell'Epiro; quindi (che io sappia) nessun codice in questa lingua, nessuna scrittura, sebbene quegli autori che allora decisero che solitamente le cerimonie sacre fossero espresse in lingua albanese, (cosa di cui ebbero conoscenza diretta) nei primi secoli della Chiesa, abbiano dovuto introdurre alcuni codici sacri. (De albanesium, Cap. Ter.)

përndryshe:

Da lodare sono quindi i moderni Macedoni che, ben istruiti nelle lettere latine nel Collegio de Propaganda fide, presero l'iniziativa di scrivere in questo idioma piissimi libri ad uso della loro gente e di consegnarli ai nostri tempi nei caratteri tipografici (noti). Nel nuovo tipo di scrittura alcuni usano i caratteri latini [...] (De albanesium, Cap. Ter.)

d) Argumenti kulturor-fetar

Guxeta përpiket në këtë rast të saktësojë idetë e tij lidhur me pozicionin e klerit arbëresh si pjesë përbërëse e unionit kristian nën suazën e Papatit dhe të Kishës Katolike Romake. Kështu:

Continuo ad illustrare i costumi degli Albanesi; una sola sia la regola per conoscerli: la sempre giusta fede catholica degli Albanesi in Cristo [...] (De albanesium, Cap. Quar.)

përndryshe:

Tuttavia vivono [gli italo-albanesi – B.D.] secondo i riti

greco (queste sono istituzioni sacre per loro e per la Chiesa) di cui non esiste nulla di più prezioso e di più sacro di ciò che la Grecia diffuse in tutto l'Oriente, e i profughi, avendoli ricevuti dalla vicina Chiesa orientale, sebbene fossero stati assegnati a quella occidentale e al Patriarcato romano in virtù degli antichi canoni, dall'Epiro li portarono con sé in Italia, carichi, se si può dire, come gli israeliti che andavano vagando verso la Palestina, di tutte le ricchezze dell'Egitto. (De Albanesium, Cap. Sec.)

d) Argumenti gjuhësor

Për Guxetën njësia gjuhësore i bashkon më së miri arbëreshët e Italisë me shqiptarët e dheut mëmë:

La storia conferma che le parlate locali (i vernacoli) sono uguali alla lingua degli Albanesi nella quale gli Italo-albanesi di casa nostra si intendono perfettamente con gli Epiroti e con i Macedoni. (De albanesium, Cap. Ter.)

Si "propria della gente albana" kjo gjuhë konsiderohet prej tij si "barbare", sepse:

[...] consta di suoni monosillabici che, per lo più, sono tenuti uniti da una sola vocale inserita (chiusa) in un gran numero di consonanti. Perciò risulta troppo dura e giustamente inseribile tra le lingue barbare, propria della natura di una gente più portata alla guerra che al foro. Di questa rozza lingua non sono soliti servirsi coloro che abitano la Macedonia e l'Epiro e, al posto di essa, usano dappertutto il volgare greco o il turco, lingue che apprendono in eguale misura fin dall'infanzia; mentre usano l'albanese unicamente in casa e in guerra: in casa per usarla durante la guerra risultando essa incomprensibile alle altre popolazioni; in guerra per aumentare, anche con la lingua, la paura nei nemici. Pur nondimeno quel semplice fiato esprime sufficientemente, anche con poche parole, i sentimenti su moltissime cose. È ricca di proverbi e di modi di dire arguti e gradevoli, artisticamente coloriti da moltissime onomatopoeie. È sorprendente che questa lingua, dagli italo-albanesi elevata alla poesia e adattata al metro siculo e ai versi italici, risuoni con grazia e grande piacevolezza. (De albanesium, Cap. Ter.)

Për të kjo gjuhë është e lashtë:

Considero antichissima questa lingua, non diversamente che la gente; infatti è giusto credere che essa non sia recente o che sia nata invano dopo la sottomissione della Grecia da parte dei Macedoni (De albanesium, Cap. Ter.)

dhe duke qenë e tillë mbetet të kryhen hulumtime rreth origjinës së saj, e cila nuk përkon me asnjërën prej gjuhëve fqinje në Ballkan. Kështu, sipas Guxetës:

Di questa lingua infine resta da ricercare se sia propria della gente albana, o se sia dipendente e prodotta da un'altra. Infatti una moltitudine di persone la considera greca: alcuni la immaginano Illirica, altri Turca. Ma in effetti, dopo che fu fatta una comparazione tra i suoni di queste lingue tra loro, si è scoperto che nessuna di quelle due concorda con la lingua albanese; se si prendessero alcune voci dalla (lingua) greca e una o due dalle altre (lingue), (si comprenderebbe) quali (sono) quelle che la lunga familiarità degli Albanesi con quelle popolazioni confinanti introdusse nell'idioma albanese. (De albanesum, Cap. Ter.)

Guxeta nuk bashkohet në vepër as me mendimin e humanistit shqiptar Marin Barleti, i cili lidhur me shqipen "pensa che quella sia la lingua latina, passata dagli Italici agli Epiroti." Për të ndikimi latin mbi shqipen është i dukshëm, megjithatë:

Anche se non del tutto, le voci barbare mostrano sufficientemente che quanto più sono proprie di questa lingua, (tanto più) sono del tutto diverse da quella latina; le flessioni sia dei nomi sia dei verbi sono così peculiari di questa lingua che non si adattano a nessun altro dialetto. Specialmente nella coniugazione dei verbi per i quali gli Albanesi si contentano del solo modo indicativo, e dei suoi tempi del presente, imperfetto e aoristo, che è simile a quello dei greci, e dell'imperativo presente, usando molte e varie circonlocuzioni per gli altri tempi e modi, alla maniera dei barbari. (De albanesum, Cap. Ter.)

3. Mendimi i Guxetës mbi etnogjenezën e popullit shqiptar

Argumentet e radhitura më sipër, të cilët Guxeta i shfrytëzon për të nxjerrë në pah dallimet thelbësore në identitetin etnik-kulturor midis arbëreshëve dhe grekëve, i shërbejnë atij në të njëjtën kohë si gurë themeli në rindërtimin e etnogjenezës së shqiptarëve, që gjëllinin atëbotë në dy brigjet e Adriatikut dhe të Jonit. Në projektin e tij largvajtës faksin sidomos dy faktorë:

- a) hapësira jetike e shqiptarëve në Ballkanin perëndimor, e cila përkon jo rastësisht me territorin e dikurshëm të atyre fiseve jogreke, të cilat Guxeta – sikurse shumëkush në kohën e tij, madje edhe në kohën e antikitetit (p.sh. Straboni) – i konsideron si epirotë, përkatësisht maqedonas; dhe
- b) gjuha e veçantë, e cila është "propria della gente albana" dhe si e tillë ruan në strukturën gramatikore dhe në leksik tiparet arkaike të një gjuhe të sertë (= rozza) barbare, e cila nuk mund të jetë tjetër veçse gjuha amtare e maqedonasve dhe e epirotëve antikë, edhe pse në rrjedhë të kohës janë përfutur ndikime dhe përzierje me gjuhët fqinje, kryesisht me latinishten, duke marrë sot trajtat e së ashtuquajturës maqedonishte moderne (= lingua macedona odierna), përkatësisht të shqipes. Kështu, sipas tij:

[...] essendosi avuta nel frattempo una grande varietà di mescolanze con altre lingue straniere, sia nella Colchide, dove gli Albani, partendo dal Lazio, si rifugiarono e dove ebbero fino a 26 lingue, cosa che riferisce Strabone, sia nella stessa Macedonia sia nell'Epiro, dove infine fissarono il loro domicilio, quanto meno essa è stata considerata latina dallo stesso Strabone. Stando così le cose, una sì grande varietà di voci, sia latine sia barbare, di cui è ricca l'odierna lingua vernacola degli albanesi, si andò componendo a tal punto che noi diciamo che essa non è del tutto latina, ma un misto di latino e di macedonico antico." (De albanesum, Cap. Ter.)

Këta dy faktorë përbëjnë në vetvete trarët mbartës të tezës që mbështet Guxeta, sipas së cilës fiset maqedone dhe epirote të Ballkanit antik, së bashku me prijësit e tyre zulmëmëdhën si Aleksandri i Madh i Maqedonisë dhe Pirro i Epirit, janë pararendësit historikë të shqiptarëve të sotëm. Fakt është që kjo tezë gëzoi përkrahje të fuqishme dhe u zhvillua në detaj në letërsinë shkencore arbëreshe të shek. XVIII-XIX, duke u ngjizur më vonë si faktor identifikues kombëtar në programin ideologjik të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (Mandalà 2006, 18vv.). Por a është Guxeta gjetësi i kësaj teze? Kësaj pyetjeje nuk jemi ende në gjendje t'i përgjigjemi shterueshëm, edhe pse gjendet ndonjë tregues që na shtyn thellë në kohë, të paktën deri në shekujt XV-XVII. Është fjala këtu për origjinën arbëreshe, përkatësisht epirote dhe/ose maqedone që nuk mungojnë ta theksojnë – madje me mburrje – brezat e parë të shkrimtarëve dhe eruditëve shqiptarë që vijnë prej arealit kulturor të Veriut, si p.sh. Marin Barleti, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani etj.² Parë nga kjo perspektivë, besojmë se nuk jemi larg së vërtetës në rast se përsiasim që kemi të bëjmë këtu me mendimin intelektual shqiptar më të hershëm dhe më afatgjatë që njohim deri më sot, pasi hyri si i tillë edhe në programin ideologjik të lëvizjes së Rilindjes Kombëtare Shqiptare³.

Në këtë rast roli i Guxetës rezulton të jetë i dyfishtë: nga njëra anë, si përcjellës i mendimit intelektual shqiptar të

2. Si dëshmi e hershme do vështruar edhe thënia e famshme e prijësit legjendar shqiptar Gjergj Kastriotit: "Se le nostre croniche non mentiscono noi ci chiamano epiroti."

3. Faktin që etnonimi diturak 'maqedon' së bashku me atë 'epirot' ka mbizotëruar së lashti mendimin intelektual shqiptar, autori i këtyre radhëve e shpjegon paraprakisht: a) me admirimin dhe respektin që gëzonte në mesjetë gjeografi aleksandrin Ptolemaios (= lat. Ptolemeus), si më i hershmi autor i antikitetit të vonë që e cakton fisin e *Albanoi-ve* në hinterlandin e Durrësit, pikërisht në provincën e atëhershme romake të Maqedonisë (shek. II e.j.); dhe a) me emërtimin e njësisë administrative kishtar *Provincia e Maqedonisë* me seli në Ohër, e cila shtrihej në perëndim deri në brigjet e Adriatikut duke përfshirë për një kohë edhe dioqezat sufragane të Vlorës, Durrësit dhe Lezhës.

kohës, e nga ana tjetër, si nxitës i shqyrtimit të mëtejshëm të këtij problemi në mjedisin kulturor italo-arbëresh, duke pjesëmarrë edhe vetë në debat. Kështu, ai nuk ngurron t'i pleksë ngushtësisht faktorët 'hapësirë' dhe 'gjuhë' që përmendëm më lart, duke përdorur si çelës metodik analizën gjuhësore të toponomastikës antike të Ballkanit. E tillë është p.sh. "la spiegazione della città di nome Pella, in Macedonia, che fu patria di Alessandro Magno e di suo padre Filippo." Kështu, sipas Guxetës:

Sicuramente albana è Pella, che in latino si traduce Equa, cioè Cavalla, e probabilmente con il termine Equa, secondo i loro costumi i Macedoni chiamavano quella città in ricordo forse di una bellissima e straordinaria Equa, confinante con la Tessaglia di Macedonia, non diversamente dall'Epiro che fu madre fecondissima di cavalli e di cavalle straordinarie, che eccellevano su tutte le altre e, una volta morte, erano tenute in grande onore. (De albanesium, Cap. Ter.)

A është bindës për studiuesin e sotëm ky interpretim gjuhësor, përkatësisht vetë teza mbi origjinën (epirote-)maqedonase të shqiptarëve? Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje mund të jetë e ndryshme. Dikush mund ta marrë atë thjesht si provokuese dhe me buzën në gaz do të nxitojë të shtojë pa të keq, që deduktime dhe rindërtime të kësaj natyre i takojnë më fort së ashtuquajturës periudhë parashkencore në ecurinë e debatit albanologjik. Shumëkush është megjithatë i prirur që t'i japë kësaj pyetjeje dyfishe një përgjigje negative, duke mëtuar: a) se interpretimi gjuhësor është thjesht dhe vetëm një asociacion tingullor krejt i rastit midis oronimit antik Pella, si vendlindja e Aleksandrit të Madh të Maqedonisë, dhe emrit të përgjithshëm pelë "cavalla"; ndërsa b) vetë teza mbi origjinën (epirote-)maqedonase të arbëreshëve nuk është gjë tjetër veçse një asociacion logjik, apo një pseudo-identifikim – i cili ndërvar në mënyrë fiktive faktorët 'kohë', 'hapësirë' dhe 'gjuhë', në kuptimin që shqiptarët, duke qenë anas në trojet e tyre etnike në Ballkanin perëndimor e që flasin një gjuhë të krejt të ndryshme nga popujt fqinjë, atëherë duhet t'i vendosim në marrëdhënie filiacioni me njërin a disa ndër popujt jogreke në pjesën perëndimore të Ballkanit antik, të cilët për Guxetën janë padyshim maqedonasit me (pinjollët e tyre) epirotët.

Gjithsesi të njëjtën pyetje – sa të thjeshtë, aq edhe të vështirë – mund ta shtrojmë edhe sa i përket tezës së ashtuquajtur shkencore që pranohet sot në shumicë në albanologji, sipas së cilës shqiptarët qenkan pasardhësit e atyre popullsive ilire që paskan zotëruar në antikitet trojet perëndimore të Ballkanit, e që qëndruan në marrëdhënie farefisnie gjenetike edhe me epirotët. Edhe kjo tezë mbështetet në instancë të fundit në po ata faktorë, që lexojmë në vepërzën e Guxetës. Dhe këta janë:

- a) hapësira jetike e shqiptarëve të sotëm në Ballkanin perëndimor, e cila përkon jo rastësisht me territorin e dikurshëm të atyre fiseve jogreke, të cilat shumëkush sot, sikurse edhe në kohën e antikitetit i konsideron si Illyri (proprie dicti) – por në këtë rast citohen autorë të tjerë antikë (p.sh. Plini i Vjetër); dhe
- b) gjuha e veçantë, e cila është "propria della gente albana" dhe si e tillë ruan në strukturën gramatikore dhe në leksik tiparet e një gjuhe barbare, që nuk mund të jetë tjetër veçse gjuha amtare e ilirëve dhe e epirotëve antikë, edhe pse në rrjedhë të kohës janë përfutur ndikime dhe përzjerje me gjuhët fqinje, kryesisht me latinishten, duke marrë trajtat e një si të thuash "ilirishteje moderne".

Ideatorin e kësaj teze, që citohet shpesh dhe bujshëm në historinë e albanologjisë, patëm rast ta përmendnim më lart. Është filozofi dhe eruditi gjerman Leibniz, një thuajse bashkëkohës i Guxetës, i cili në fakt shkruan vetëm për "[...] un livre & un Dictionnaire de la Langue Albanoise; par là nous apprenons quelle étoit la langue des anciens Illyriens. ..." (Opera omnia V, f. 494). Ishin këta librat e dy autorëve shqiptarë të gjysmës së parë të shek. XVII, të cilët i kumtuan Leibniz-it tiparet themelore të shqipes si një gjuhë e mëvetësishme në Ballkanin perëndimor: Doktrina e Krishtenë e Pjetër Budit, e sidomos Fjalori latinisht-epirotisht, vepra e parë e mirëfilltë albanologjike që njohim deri më sot me autor Frang Bardhin. Leibniz-i sigurisht nuk mësoi as prej Pjetër Budit dhe as prej Frang Bardhit origjinën ilire të shqipes. Ata vetë e quajnë veten sipas rastit (i) arbëneshë, epirot ose i dheut të Macedonisë. Por në librat e tyre ai kërkoi dhe gjeti informacionin e nevojshëm për mëvetësinë dhe përhapjen gjeografike të shqipes si gjuhë që flitej në perëndim të Ballkanit. Përndryshe ne jemi të mendimit që origjinën ilire të shqipes ai e përsiati thjesht dhe vetëm, sepse kishte një tjetër koncept mbi hartën demografike të Ballkanit antik.

4. Vendi i Guxetës në historinë e albanologjisë

Në rast se lejohe mi së fundi të ballafaqojmë këta dy dijetarë nga perspektiva e historisë së mendimit albanologjik, nuk bëjmë gjë tjetër veçse përjasim rezultatet e arritura prej tyre, parë këto si fryt i shkallës së njohjes dhe i debatit albanologjik në dy areale kulturore, që deri atë kohë nuk rezultojnë të kenë pasur kontakte të ndërsjella, përveç shkëmbimit të ndonjë libri të rrallë. Të dy dijetarët i bashkon me njëri-tjetrin në radhë të parë operacioni – do të thonim – logjik, parë ky si bashkëlidhje, përkatësisht ndërvarësi kausale e faktorëve 'kohë', 'hapësirë' dhe 'gjuhë'.

4. Një përpjekje të parë për të bashkërenduar rezultatet e arritura në dy këta dy areale i hasim në fillim të shek. XIX në veprën e italo-arbëreshit Angelo Masci: *Discorso sull'origine, costumi, e stato attuale della nazione Albanese*, Napoli 1807.

Që rezultatet e tyre janë të ndryshme – siç mund të ishin edhe të njëjta – këtë dallim mund dhe duhet ta përcjellim sot si sipërfaqësor, sepse ka të bëjë thjesht dhe vetëm me pozicionimin e njërit apo tjetrit dijetar ndaj ndërlikës së marrëdhënieve etnike në pjesën perëndimore dhe qendrore të Ballkanit antik, për të cilin dëshmitë gjuhësore të mirëfillta mungojnë⁴.

Dallimet konsistojnë më fort në aktivitetin intelektual dhe social të njërit dhe tjetrit dijetar lidhur me kërkimin albanologjik në përgjithësi. Kështu, Leibniz-i gjatë trajtimit të historisë së popullit shqiptar, por edhe të gjuhës shqipe, vepron kryesisht si enciklopedist, ndërsa Guxeta me

vepërzën e tij sendërttoi një projekt afatgjatë të kërkimit albanologjik me pretendime të mirëfillta shkencore në të ardhmen. Në këtë kuadër edhe fjalja përmbyllëse e këtij projekti:

Allo stesso modo crediamo di fare (forse) una cosa gradita agli studiosi dell'antichità e a coloro ai quali, assieme agli uomini più eruditi, piace fare ricerche sulle origini delle lingue. (De albanesum, Cap. Ter.)

ruan sot e gjithë ditën në shkencën tonë të shenjtë të albanologjisë vlerën e fjalës apostolike.

BIBLIOGRAFI

Altinari, Francesco: *Il movimento culturale della Rilindja e il Collegio di S. Adriano nella prima metà del secolo XIX, nr. 11 i serisë "Quaderni di Zjarri" 11 [1984]. Cosenza*

Bartl, Peter: *Über den Ritusstreit in den Italo-Albanischen Gemeinden Kalabriens im 18. Jahrhundert*, në: "Studia albanica monacensia. In memoriam Georgii Castriotae Scanderbegi 1468-1968", München 1969, f. 32-46

Borgia, Nilo: *I monaci basiliani d'Italia in Albania. Appunti di storia missionaria (Secoli XVI-XVIII)*. Periodo secondo, Roma 1942

Demiraj, Bardhyl: *Si të lexojmë Leibniz-in*, në: "Seminari

ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare (Prishtinë-Prizren, gusht 2000)", Prishtinë 2001, S. 359-371.

Guzzetta, Giorgio: *L'osservanza del rito preso gli Albanesi d'Italia perché giovino a se stessi e a tutta la Chiesa* (= titulli i origjinalit në dorëshkrim: *De Albanesium Italiae ritibus excolendis ut sibi totique S. Ecclesiae prosint*), Palermo 2007.

Mandalà, Matteo: *Vepra e pabotuar e At Gjergj Guxetës dhe fillimet e albanologjisë në shek. XVIII*, në: "Studime Filologjike" 1-2 [2006] 11-41

Rodotà, Pompilio: *Dell'origine, progresso, e stato presente del rito greco in Italia osservato dai greci, monaci basiliani, e albanesi*, Vol. III, Roma 1758

BIG THINK - MAGAZINA E IDEVE ON-LINE

Kultura është objekti kryesor i faqeve të protagonistit më të ri të rrjetit social në web: Big Think, një lloj YouTube i ideve.

Projekti lindi më 2006, kur njeri prej themeluesve të platformës së re video, Peter Hopkin, i diplomuar në Harvard takoi Lawrence H. Summers, ekonomist dhe ish ministër i thesarit në SHBA. Ata menduan të krijojnë një uebsajt ku të shkëmbehen video dedikuar kryesisht intelektualëve.

Pas një viti organizimi e provash, Big Think arriti këto ditë zyrtarisht on-line, me një bagazh intervistash me njerëz të shkencës, politikanë e menaxherë të suksesshëm, përfaqësues të çdo sektori (aktualisht janë 2510 ide video). Ky rrjet është i hapur për të gjithë e synon që të kthehet në një arenë diskutimesh e debatesh për argumente nga më të ndryshmet. Çdo vizitor është i ftuar që të regjistrohet e të bëhet pjesë aktive e rrjetit duke sjellë materiale të reja por edhe duke diskutuar, votuar

apo duke komentuar ato të parafolësve.

TEMATIKAT DHE OBJEKTIVAT – Mjedisi, teknologjia, historia, ekonomia dhe mediat janë vetëm disa nga kanalet rreth të cilëve do të grupohen diskutimet dhe kontributet e pjesëmarrësve të thjeshtë dhe profesionistëve, që do të pasurojnë më tej faqet e Big Think-ut.

Shpresa e Hopkin dhe bashkëpunëtores së tij, Victoria Brown, është që ky uebsajt të kthehet në një pikë referimi për studentët që kanë nevojë për burime origjinale e të besueshme për studimet e tyre. Pikërisht për të zhvilluar aspektin social, kjo platformë do të pasurohet shpejt me një aplikim si Facebook, i cili do të bëjë të mundur krijimin e një rrjeti të vërtetë për shkëmbimin e ideve.

Corriere della Sera

Shkencëtarët që në fusha të ndryshme punojnë mbi argumente teorike, kanë si instrument të vetëm shkrimin. Gjithçka duket shumë e thjeshtë. Në të kundërt, shkencëtarët që kryejnë eksperimente punojnë në laboratore. Laboratori mund të jetë krejt bota, hapësira apo një qilar i vogël. Ka qenë gjithmonë kështu e kështu do të mbetet. Por, nëse pyesim se me çfarë do të merren studiuesit pas 20 apo 30 vjetësh, përgjigja mund të jetë shumë e vështirë apo e pamundur. Po të ktheheshim në fillim të shekullit XX e po të bënim të njejtën pyetje do të gjendeshim në të njejtën situatë: as atëhere nuk dihej se si do të ishte e ardhmja. Patjetër që ka pasur persona me ide mjaft të goditura edhe pse ju mungonte aftësia teknike për të shpjeguar në detaj se si intuicionet e tyre mund të funksiononin, edhe pse të bazura mbi parime fizike. Këta ishin shkrimtarët e fantashkencës.

do të evolonte diagnostika me imazhe dhe Ernest Rutherford e Niels Bohr nuk mund të parashikonin zbulimin e grimcave subatomike apo fenomenin e rizonancës manjetike. Gjithë kjo vërteton se e ardhmja e zbulimeve shkencore nuk mund të parashikohet edhe pse mund të imagjinojmë nga mund të lindin disa njohuri të reja e të rëndësishme.

Një pyetje tjetër vendimtare prek rolin që shkencëtarët do të luajnë në jetën sociale. Si do të përdoren informacionet e mbledhura prej tyre? A do të jetë dikush që do ti urdhërojë ata se cilat informacione të mbledhin? (Perspektivë kjo aspak gazmore).

Le të marrim Albert Einstein-in, ndoshta shkencëtari më i njohuri shekullit të kaluar. Aftësia e tij për të vlerësuar me qartësi edhe problemet jashtë fizikës e të fliste me plot forcë e vendosmëri ishte diçka e admirueshme. Takohet me kënaqësi me personalitetet e

përdorimin optimal të dijeve të tyre. Në SHBA na kanë inkurajuar që t'u japim përfaqësueve tanë politikë informacionet që kemi e të shpjegojmë se si mund të shfrytëzohen me efikasitet gjatë marrjes së vendimeve politike. Po si mund të përballojmë problemet ekologjike në rritje të cilët u vunë në pah së pari nga biologjia dhe shkrimtarja Rachel Carson? Një ditë karburantet fosile do të shterojnë. Ndoshta do të duhen 100 vjet, pak a shumë. Duhet të gjejmë rrugën për të pastruar gazrat e çliruar nga këto karburante, gjë që tani për tani është tepër e kushtueshme. Në vend të tyre mund të përdorim energjinë hidroelektrike, atë gjeotermike, erën etj. Edhe energjia nukleare për përdorim paqësor mund të jetë e pranueshme nëse arrijmë të përpunojmë skorrjet radioaktive. Një rëndësi të madhe kanë edhe modifikimet gjenetike të baktereve që përdoren për

TOKA JONË ËSHTË VËNË NË LOJË

Thirrje e Sydney Altman, çmim Nobel për kimi, 1989:

«Shkencëtarë, ejani të ndotim duart: politika ka nevojë për ne»

Jules Vernes na ka dhënë një kuadër të jetës në nëndetëse bile dhe me palombarë që ecnin në fondalet e oqeanit. Ai parashikoi edhe një udhëtim në Hënë por në këtë rast njihet vetëm sipërfaqësisht problemet që duhet të kalojë një raketë që të mposhtë forcën e rëndesës së Tokës. Përveç shpikjes së njeriut të padukshëm, H.G. Wells përshkroi një luftë midis qenieve jashtëtokësore dhe banorëve tokësorë. Disa shkencëtarë arritën të shohin edhe fuqinë që vetë shkenca kish në vetvete. Idetë e tyre të ndritura jnë në bazë të një pjese të mirë të teknologjisë aktuale.

Guglielmo Marconi ishte njeri prej tyre. Qysh i ri ai kuptoi se valët e radios mund të dërgoheshin në largësi dhe arriti ta demostrojë këtë duke transmetuar sinjale midis Kanadasë dhe Irlandës. Wilhelm Roentgen, nuk e dinte se si

periudhës së tij: ekziston një sërë fotografish me Charlie Chaplin-in në kulmin e suksesit të tij. Por, Einstein-i, së bashku me fizikanin tjetër Leo Szilard, kontribuan që qeveria amerikane të nxiste krijimin e bombës atomike për shkatërrimin e armatave naziste gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Lufta më në fund mbaroi por gjërat nuk shkuan ashtu si shpresohet. N.q.s. do të ketë një luftë tjetër ku njera nga palët do të përdorte armë atomike, mjedisi dhe e ardhmja jonë do të rrezikoheshin rëndë.

Jam i bindur se shkencëtarët duhet të inkurajojnë qeveritë për të përdorur njohuritë e tyre prej specialistësh kur bëhet fjalë për marrje vendimesh që do të influencojnë mbi shoqërinë tonë.

Nuk besoj se studiuesit duhet të kufizohen vetëm me një konsulencë shkencore: ata duhet të tregojnë edhe

pastrimin e shkarkimeve industriale.

Të mirat në shërbim të mijëra njerëzve, është një argument si i karakterit biologjik ashtu edhe atij ekonomik, që shkon në favor të përdorimit të inxhenerisë gjenetike.

E së fundi, si mund të imagjinohet e ardhmja? Ndoshta plot me automjete që përdorin energjinë elektrike dhe një numër i madh robotësh inteligjentë në shërbim të njerëzimit.

Të gjitha këto tingëllojnë si ide qesharake. Gjëja më e rëndësishme, ajo që është e sigurtë, është se nëse shpëtojmë planetin tonë nga shkatërrimi, mrekullia e paparashikueshme e shkencës do të na ofrojë perspektiva të reja se si të shfrytëzojmë hidrogjenin e, në përgjithësi, se si të përdorim elementë që më parë nuk ishin marrë fare në konsideratë.

Përmbledhi Roland Lelaj

Nanoteknologjia dhe çmimet Nobel 2007

Chmimet Nobel përcaktojnë aktualitetet shkencore dhe jepen në bazë të rolit apo rëndësisë së zbulimeve për jetën dhe mirëqenien e njeriut. Këto çmime për shkencat natyrore këtë vit vërtetuan se hulumtimet në nanoshkallët e sistemeve të gjalla apo jo të gjalla si dhe magazinimi e rrjedhja e informacioneve në këto sisteme janë në qendër të hulumtimeve moderne shkencore dhe të potencialit të zbatueshmërisë së tyre praktike. Këtë e vërtetuan edhe tre çmimet e dhëna në fizikë, mjekësi dhe kimi, të cilat do të përpiqemi t'i komentojmë në këtë artikull.

NANOTEKNOLOGJIA

Përpara komenteve tona mbi zbulimet që u nderuan me çmimet Nobel në fjalë, le të bëjmë një hyrje të shkurtër për kuptimin e nanoteknologjisë, rolin e informacioneve në qendrën kontrolluese të materies apo sistemeve të gjalla, si dhe dallimit të tyre nga materia jo e gjallë. Këtë mund ta shprehim me një ngjarje shumë të largët në kohë e cila fillon para mëse 14 miliardë vitesh, pikërisht në momentin e krijimit apo Big-Bang-ut. Mendohet se para atij momenti (kjo mbetet sfidë e diturisë së ardhme njerëzore) ekzistonte vetëm potenciali apo energjia, e nuk bëhej fjalë për kohë, hapësirë apo materie të çfarëdo lloji. Pas eksplozionit të madh filloi formimi i grimcave primitive materiale, kuarceve, më vonë kuanteve e deri në formimin e atomit më primitiv, atomit të hidrogjenit. Më pas, nëpërmjet transmutacioneve formohen elementët e rëndë (deri tek hekuri) dhe nëpërmjet plasjeve (supernova) formohen elementë edhe më të rëndë duke plotësuar vargun e të gjithë elementëve të materies që kemi sot në gjithësi. Nga kjo materie përbëhen galaktikat, yjet, planetët por edhe trupi dhe mendja e njeriut e cila në këtë fillim të shekullit

XXI po merret me sekretet, strukturat apo dhe proceset më të ndërlukuara të botës së gjallë dhe jo të gjallë.

Në ngjarjen e përshkruar miliarda vjet më parë, vlen të theksohet se në strukturat materiale, grimcat nanometrike ishin ndër blloqet e para të përbërjes së materies dhe të sistemeve gjigande siç është toka apo yjet. Kronologjia e zhvillimit apo mënyra e ndërtimit material përkon me teorinë nanoteknologjike të ndërtimit nga brenda jashtë. Pra, nga elementët themelorë tek trupi në tërësi. Këtë strategji ndërtimi nanoteknologjia e ka zgjedhur pikërisht duke kopjuar natyrën. Le të shpjegohe mi më qartë: në ndërtimet konvencionale, ndërtimi fillohet nga muret, struktura të jashtme, e pastaj vazhdohet me pjesët e brendëshme. E njëjta procedurë ndiqet për ndërtimin e automjeteve, nga jashtë-brenda.

Procedura nanoteknologjike, ndryshe nga më sipër, është pikërisht në drejtim të kundërt nga brenda-jashtë. Sipas një procedure të tillë janë edhe strukturat biologjike si një masë muskulore, kockore, organet etj. Me informacionet që dalin nga qendra kontrolluese informative, për të cilën do të flasim më poshtë, në bazë të strukturës së ADN-së kontrollohet ndërtimi i proteinave deri në sistemin muskular, organe etj. Energjia për këtë lloj ndërtimi apo fabrikimi vjen nga proceset e mirënjohura metabolike në nivel qelizor.

Ky informacion apo qendër informative e bën qelizën apo njësitë dhe sistemet e gjalla të dallohen nga materia jo e gjallë. Në llojin e dytë të materies, komponimi apo dinamika materiale kryhet pa një qendër kontrolluese informative. Energjia e komponimit material në këtë rast bazohet në ligjet fizike, kimike dhe në probabilitetin e ngjarjeve që përcaktojnë fatin e objektit.

Kapja e imazheve të strukturave që i përkasin një bote apo hapësirë shumë të vogël nanometrike (të miliardën



pjesë të metrit) e bazuar në metodat nanoskopike që tejkalojnë vrojtimin e bazuar (dhe të kufizuar) në difraksion e valëve elektromagnetike, hapin rrugë të reja hulumtuese përkrah depërtimit në sekretet më të imta të materies së gjallë dhe jo të gjallë si dhe të sistemeve informative procesuese, bartëse dhe magazinuese. Ne këtë front të vizioneve hulumtuese janë edhe zbulimet e çmimet Nobel të këtij viti të cilat po mundohemi ti komentojmë për një pasqyrim transparent dhe që t'ju lehtësojmë kolegëve të rinj kuptimin e esencës së zbulimeve në fjalë.

ÇMIMET NË FIZIKË DHE MJEKËSI

Më 16 tetor 2007 francezi Albert Fert dhe gjermani Peter Gruenberg fituan çmimin Nobel në fizikë për zbulime në mënyrë të pavarur në vitin 1988. Albert Fert, tani në moshën 68 vjeçare, është drejtor i Njesisë për Fizikë në CNRS/hTales në Orsey të Francës. Peter Gruenberg, tani në moshën 69 vjeçare, është profesor i Institutit për Studime të Trupit të Ngurtë në qytetin Juelich të Gjermanisë. Të dy këta shkencëtarë zbuluan efektet fizike të cilat bëjnë të mundur leximin e informacioneve ultra të imta të regjistruara në hard disk apo mjedis tjetër regjistruar. Ky efekt quhet magneto rezistencë gjigante (MRG). Është fjala për fenomenin ku shndërrime shumë të dobëta magnetike gjenerojnë shndërrime shumë të mëdha të rezistencës elektrike. Në bazë të këtij fenomeni, informacionet e regjistruara në mënyrë magnetike mund të shndërrohen në sinjale elektrike të cilat mund të lexohen nga kompjuteri si të tilla.

Ndërkaq një ditë më parë, më datën 15 tetor, u shpall çmimi Nobel në mjekësi. Këtë çmim e fituan amerikanët Mario R. Capecchi, Oliver Smithies dhe Briton Sir Martin J Evans për studime në manipulimin e gjeneve të minjve.

Erik Dexler, personazhi më i njohur në botë për propagandimin e nanoteknologjisë deklaronte vite më parë që manipulimet gjenetike në nivel të ADN-së së bërthamës qelizore do të kryejnë zbulime revolucionare. Ky çmim dhe zbulimet e tjera të kësaj natyre që kanë të bëjnë me strukturat molekulare të ADN-së dhe rrjedhjen e urdhërave informative për sintetizimin e proteinave dhe kontrollin e energjisë në nivel qelizor apo metabolik, do të jenë bazë edhe për zbulime dhe çmime të tjera të rëndësishme në të ardhmen.

Nuk është rastësor fakti që dy zbulimet e çmimeve Nobel në fjalë edhe pse janë në lëmi të ndryshme kanë një bazë të përbashkët. Që të dy përshkruajnë fenomene të cilat ndodhin në hapësira shumë të vogla dhe të dy janë të lidhur me procesin e magazinimit të informacioneve dhe qarkullimit të tyre nga burimi në formë të caktuar sinjalesh. Dallimi qëndron në faktin se zbulimi në fizikë ka të bëjë me strukturën e grimcave që në formë të sasive tepër të vogla magnetike regjistrohen informacionet në hard disk.

Shkrimi i informacioneve bëhet në mënyrë magnetike, ndërsa leximi i tyre, në bazë të shndërrimit të rezistencës kryhet me anë të sinjaleve elektrike.

Strukturimi i grimcave në hard disk apo mjedis tjetër regjistruar të teknologjisë informative si dhe shkrimin e informacioneve e kryen njeriu në mënyrë artificiale. Le të kujtojmë këtu faktin që kemi të bëjmë me magnetet ultra të vogla. Po ashtu le të kujtojmë që fusha magnetike është pasojë e ekzistencës së rrymës apo lëvizjes së ngarkesave elektrike. Meqë elektroni është shembull i ngarkesës më të vogël të mundëshme, lëvizja apo lëvizjet relative rrotulluese (spinore) të tij gjenerojnë sasinë më të vogël magnetike dhe përfaqësojnë magnetet më të vegjël të mundshëm.

Ndërkaq strukturimi i elementeve të ADN-së në brendësi të gjenit apo bërthamës qelizore, që në fakt përfaqëson strukturën informative urdhëruese e cila qeveris energjinë e gjeneruar në nivelin qelizor, është shkruar me shekuj në mënyrë evolutive trashëguuese. Me manipulimin e këtyre strukturave në mënyrë të qëllimshme tek minjtë, shkencëtarët arritën të ndryshojnë informacionet bazë (të cilat vijnë nga AND-ja gjenetike apo qelizore për ndërtimin e organeve, apo funksioneve organike të minjve).

Dexler thotë që: "bioteknologjia dhe klonimi janë procese nanoteknologjike të cilat janë të bazuara në manipulime në nivel të hapësirave apo grimcave ultra të vogla me qëllim të kontrollit të makro proceseve të cilat kanë efekte praktike apo të cilat do ta mundësojnë ndryshimin e botës ekzistuese". Pra kemi të bëjmë me një ndërtim i cili plotësisht dallohet nga ai ekzistues. Përderisa ndërtimet tani (në kuadër të teknologjisë konvencionale ekzistuese) bëhen sipas parimit jashtë-brenda, parimi i ndërtimeve nanoteknologjike është plotësisht i kundërt brenda-jashtë.

Ndonëse kemi të bëjmë me dy lëmi shkencore të ndryshme mund të thuhet se këto kanë elemente të përbashkët që përbëjnë bazën filozofike të të dy zbulimeve në fjalë. Zbulimet nuk mund ta fitonin çmimin Nobel nëse nuk do të kishin rëndësi të madhe për njerëzimin apo mundësi të madhe praktike.

Për ta kuptuar më mirë rolin e zbulimit në lëminë e fizikës vetëm shihni kompjuterin tuaj portativ apo telefonin celular ku janë të regjistruar një numër shumë i madh informacionesh. Tani, zbulimi i efektit fizik për të cilin u dha çmimi Nobel, mundëson që numri i informacioneve që regjistrohen në një hard disk të rritet 100 apo 200 herë më tepër. Kjo njëkohësisht bën të mundur zvogëlimin e mëtejshëm të përmasave të kompjuterit apo mjediseve të tjera regjistruar. Kjo shkon drejt konfirmimit të teorisë së parashikuar nga Drexler që një ditë do të zbulohen nanobote, kompjuterat me madhësi nanometrash të cilat në memoriet e tyre regjistruar do të kenë informacione

që të kalojnë edhe mençurinë e mjekut të sotëm apo aftësi shumë më të mëdha manipulative, duke qenë në gjendje që ta ndryshojnë strukturën e materies. Nanoboti, thotë Drexler, i futur në enët e gjakut do të jetë në gjendje të eliminojë helmet apo kompozimet e dëmshme kimike në organizëm.

Në anën tjetër roli praktik i zbulimit në mjekësi ka të bëjë me modifikimin e gjeneve me anë të qelizave embrionale (stem cells). Kjo nënkupton mundësinë e gjenerimit të një skeme mutacionesh në gjenet e minjve të cilat mundësojnë kuptimin e detajeve të rëndësishme të imunologjisë, neurobiologjisë dhe metabolizmit. Të gjitha këto kanë rëndësi kolosale në trajtimin e shumë sëmundjeve të cilat ende janë të pa trajtueshme apo sot trajtohen me efikasitet të ulët.

NANOTEKNOLOGJIA DHE ÇMIMI NOBEL NE KIMI

Gjermani Gerhard Ertl, më 10 tetor 2007 fitoi çmimin Nobel për hulumtimet dhe zbulimet e proceseve të reja kimike në sipërfaqen e trupave të ngurtë. Ai me metoda të kapjes së imazheve nanoskopike arriti “të përcaktojë mekanizmat molekularë të sintezës së amoniakut nëpërmjet hekurit (i bazuar në procesin e mirënjohur Huber-Boch) dhe kryen oksidimin katalitik të monoksidit të karbonit nëpërmjet palladiumit (i cili shërben si konvertor apo transformues katalik)”.*

Për hulumtimet e tij Dr. Ertl zbatoi metodat e imazheve nanoskopike të zbuluara qysh në vitin 1988. Por, pasi u arrit një kufi i mikroskopit të bazuar në difraksionin nëpërmjet thjerrës, aftësia zbërthyes e tij në detaje ultra të imta u pa që ka kufizimet e saj. Meqë thjerrëza e mikroskopit ishte ajo që përcaktonte kufizimet e imazheve, filloi të mendohet se si të arrihej një mikroskopi pa praninë e thjerrës. Deri në një farë shkalle këtu ndihmonin metodat holografike. Por më vonë lindi ideja që me anë të efekteve fizike si forca bashkëvepruese e dy grimcave, të shndërrohet në imazh sipërfaqja që vëzhgohet. Me një gjilpërë, maja e së cilës është një atomike, kryhet skanimi i sipërfaqes që vrojtohet. Duke kaluar mbi grimcën korresponduese mbi sipërfaqe, maten forcat ultra të dobëta bashkëvepruese të grimcave. Matja vazhdon gjatë tërë skanimit të grimcave të sipërfaqes. Në këtë mënyrë forcat bashkëvepruese të dy grimcave, maja e gjilpërës dhe grimcave korresponduese përballë kësaj maje, gjenerojnë imazhin e sipërfaqes me të gjitha detajet nanoskopike.

Në këtë mënyrë lindi Mikroskopi Tunel Skanues (STM) për të cilin Greg Bining dhe Heinrich Rohrer morën çmimin Nobel në vitin 1986. Me këtë eveniment lindi nanoshkenca dhe nanoteknologjia e cila duke qenë komplementare me teknologjinë informative shënojnë revolucionin tekniko-shkencor të këtij shekulli.

Gerhard Ertl kreu observimin nanometrik të sipërfaqes

së trupave të ngurtë gjë që u bë me mikroskopi nanometrike të bazuar në STM, në difraksionin e elektroneve të energjive të dobëta dhe në spektroskopit fotoelektronike ultravioletë. Janë këto teknika të cilat sot përdoren në laboratorët modernë të imazheve balistike dhe jo lineare apo fluoreshente-spektroskopike. Bazuar në metodat e vrojtimit të grimcave ultra të imëta të sipërfaqeve të metalit ai arriti për herë të parë të zbulojë një fenomen shumë të rëndësishëm i cili në fakt është fenomeni i reaksioneve oshilatore në sipërfaqen e platiniumit dhe ato që manifestohen gjatë reaksioneve kimike të përmendura në fillim.

Zbulimi i Dr. Ertl, në fakt, është vazhdimësi e zbulimeve Haber-Boch, të cilat quheshin e ardhmja më e rëndësishme e shekullit dhe që mundësuan sintetizimin e amoniakut nga azoti dhe hidrogjeni. Për këtë Haber pat fituar çmimin Nobel në vitin 1918, kurse po këtë çmim Boch e pati fituar në vitin 1931. Ertl, më pas, mori vlerësimin e lartë për kontributin e tij në kiminë e sipërfaqeve meqë zbuloi absorbimin e hidrogjenit dhe azotit, i cili pason me formimin hap pas hapi të amoniumit dhe desorbimin. Shkalla që përcakton hapin në fjalë varet nga disociimi i azotit të absorbuar të molekulave të azotit”.**

Zbulimi i G. Ertl ka rëndësi të veçantë në sqarimin e mekanizmave të caktuar kimikë që hasen në sipërfaqen e metaleve por ka edhe rëndësinë praktike në hulumtimin e sipërfaqeve të metaleve në përgjithësi.

PERSPEKTIVA JONË KOMBËTARE

Në këtë vështrim, duke u munduar të ofrojmë informacione me gjuhë sa më të kuptueshme për lexuesin, nuk pretendoj të futem në detaje të shumta profesionale. Duke transmetuar të dhënat ekzistuese bazuar në teorinë e procesimit dhe magazinimit të informacioneve dhe fenomeneve nanoteknologjike, bëra disa komente për trajtimin e analogjisë së këtyre dy zbulimeve me rëndësi të madhe për njerëzimin.

Dua të theksoj se Instituti Alb-Shkenca ka në gjirin e tij hulumtues të cilët merren pikërisht me probleme të kësaj natyre. Kjo u pa qartë në tubimin e Prishtinës ku me prezantimet e tij Arben Merkoçi dëshmoi që është një ekspert ndërkombëtar në lëmin e nanoteknologjisë. Me të kemi hapur biseda dhe mundësi praktike të bashkëpunimit shkencor të cilat në të ardhmen jo vetëm do të kenë rëndësi bilaterale, por me siguri do të përfshijnë edhe anëtarë të tjerë të rinj të Institutit tonë

Ndërkaq, në lëmin biologjisë molekulare dhe gjenetikës dua të veçoj një shkencëtar tjetër të mirënjohur, Bajram Berishën, i cili në tubimin e Prishtinës publikoi rezultate imponante shkencore. Thellësia e mendimit të tij shkencor, energjia kreative që ai demonstroi të jep të kuptosh që ai ka padyshim nivelin më të lartë shkencor bashkëkohor për

lëmin e tij. Lajmi i këtyre ditëve që ai renditet në mesin e 30 autorëve më të cituar në lëmin e biologjisë së riprodhimit, vërteton edhe një herë rolin e tij në shkencë në përgjithësi dhe në IASH në veçanti.

Unë, pas një pune shumë të gjatë kam arritur rezultate të dalluara në lëmin e përpunimit optik dhe spektroskopik të informacioneve me anë të lazerit. Gjenerimi i strukturave filmike nanoteknologjike, karakterizimi i tyre me spektroskopik fluoreshente lazerike me qëllim regjistrimin dhe leximin e informacioneve janë një kontribut me të cilat po përpiqemi të krijojmë struktura të reja për magazinimin dhe procesimin e informacioneve.

I përmenda këto tre raste të Forumit dhe Institutit Alb-Shkenca, por me siguri ka shumë të tjera, shumë hulumtues të rinj të cilët janë apo do të jenë edhe më të mirë se të përmendurit. Formimi dhe komunikimi në IASH konstatoi potencialin e lartë shkencor të nivelit bashkëkohor të studiuesve shqiptarë. Ndaj edhe kërkesat tona kosovare për barazi ekonomike e politike me fqinjët serbë janë të logjikshme dhe të bazuara.

PËRFUNDIM


Zbulimet apo çmimet Nobel të komentuara, përfaqësojnë natyrën e frontit të hulumtimeve shkencore në fillim të shekullit XXI. Pikat e këtij fronti edhe pse karakterizohen me thellësi të specializimit të disiplinës së caktuar shkencore, kanë elementet e tyre të përbashkëta. Ato janë të bazuara në metodologjinë e nanoshkencës e nanoteknologjisë dhe në rrjedhjen e procesimin e informacioneve në sistemet e caktuara materiale, të gjalla apo jo të gjalla. Nga kjo rrjedhë kanë lindur e lindin disiplina të reja shkencore të cilat krahas thellësisë shumë të madhe apo specializimit shumë të ngushtë shkencor, çuditërisht kërkojnë edhe një lidhshmëri interdisiplinore të gjerë. Duhet konsideruar këtu se globaliteti dhe individualiteti i sotëm i jetës shoqërore janë pasojë edhe të zhvillimeve të njohurive shkencore.

(Falenderoj mikuntim, Dr. Robert Magarin, për inkurajimin për këtë shkrim si dhe për ndihmën në aspektin gjuhësor).

*<http://chemistry.about.com/>

**chemistry.about.com/mbiophage.htm

NANOTEKNOLOGJIA NË DREJTIMIN E QELIZAVE TERAPEUTIKE



Një grup studiuesish në Children's Hospital në Filadelfia ka vënë në praktikë një teknikë me të vërtetë inteligjente për të drejtuar qelizat me interes terapeutik në një pikë të caktuar të organizmit, atje ku ka nevojë. Kjo metodë bazohet në veshjen e qelizave me nanogrimca hekuri duke krijuar kështu mundësinë që ato duke iu nënshtruar një fushe manjetike të drejtuar nga jashtë të mund të zhvendosen pa vështirësi në pjesën e interesuar të trupit të njeriut. Këtë lajm e dha së fundi revista *Proceedings of the National Academy of Sciences*.

Kjo praktikë është përdorur tashmë në kafshë laborator për të dërguar qeliza endoteliale në disa stent metalikë të vendosur më parë në arteriet karotide për të mbajtur hapur enët e gjakut që ai të qarkullojë lirisht. Në shumë raste, efikasiteti i stentëve me kalimin e kohës zvogëlohet sepse qelizat muskulore grumbullohen në sipërfaqen e tyre duke shkatëruar përsëri një shtrëngim të ri të enës së gjakut ku është vendosur ky stent.

Për të kapërcyer këtë problem, mjafton të futen në enët e gjakut të interesuara qeliza të reja endoteliale të cilat veshin një sipërfaqe të pastër të enës. Është pikërisht ajo që arritën të bëjnë studiuesit amerikanë të koordinuar nga Robert Levy.

"Kemi përdorur grimca acidi poliatik, një polimer i biodegradueshëm, të saturuara me oksid hekuri", shpjegon Levy.

"Në një moment të dytë, kafshët iu nënshtruan një fushe manjetike uniforme të jashtëme, e aftë që të manjetizojë si nanogrimcat ashtu edhe stentët për të nxitur kështu një forcë tërheqjeje reciproke".

Studiuesit shpresojnë që e njëjta teknikë të mund të përdoret për të trajtuar edhe lloje të tjera patologjish tek njeriu dhe kafshët.

PNAS

Për një kushtetutë shqiptare

Argumenti është i thjeshtë: “Shqiptarët nuk kanë tradita as demokratike, as shtet-formuese, as kushtetuese. Ata nuk dinë të bëjnë kushtetutë, për rrjedhojë duhet t’i ndihmojmë ne, të huajt.” Pa u zgjatur më tej në kundërshtimin e këtyre tezave të padrejta dhe të pavërteta, mjafton t’i kthehemi një momenti shumë të veçantë në historinë e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri, atij të Republikës së Korçës në vitet 1916-1917.

“Republika e Korçës sot për sot është ndofta i vetmi shtet në Evropë që ka një buxhet të ballancuar dhe pa deficite...” do të shkruante më 28 shkurt 1916, korrespondenti ushtarak i revistës frënge *L’Illustration*, Robert Vaucher. “Mbështetur në Kushtetutën e Shtetit të ri, Gjendarmeria [e Republikës] ka detyrë mbrojtjen e integritetit të territorit dhe pavarësisë shqiptare.”

Dhe më tej: “Shqiptarët na provuan se janë të aftë të bashkëjetojnë më së miri me njeri-tjetrin [*sont capables de vivre en bonne intelligence les uns avec les autres*]. Grindjet fetare nuk ekzistojnë më për arësytën e vetme se nuk ka se kush t’i nxisë ato...”

Pra, në kulmin e zjarrit dhe gjakderdhjes që kishte mbjellë Lufta e Parë Botërore, një provincë e lirë e Shqipërisë së pushtuar, e cila ishte e lirë pak a shumë në kuptimin e vetëqeverisjes, i plotësonte atributet e një demokracie kushtetuese evropiane.

Le të zhvendosemi në vitin 1998, ose vitin e Kushtetutës së tashme të Shqipërisë. E paraqitur si Kushtetuta që vetvetiu do të sillte hapjen e portave të Evropës [“këtu fillon e ardhmja” – mburrej një botim i saj i parë qysh në kopertinë], ligji themeltar i shtetit të shqiptarëve përbën ndofta dokumentin që reflekton më pak traditën kushtetuese shtetërore e qeverisëse vendase. Mund të thuhet se, me përjashtim të Statutit Themeltar të Shqipërisë së vitit 1913, të hartuar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, Kushtetuta e vitit 1998 përbën shembullin më të skajshëm të angazhimit të juristëve jo-vendas në procesin e hartimit kushtetutes, po edhe modelin më eklektik sa i takon huazimit të koncepteve apo shartimit të modeleve që burojnë nga tradita dhe shkolla të vendeve të tjera. “Copy and paste” [kopjoje dhe përngjite] ma karakterizoi me mprehtësi para disa kohësh një zyrtar

dhe juriste shqiptare atë ushtrim kushtetues që pruri në jetë Kushtetutën e vitit 1998.

Këtu nuk është aspak synimi për të ulur vlerat që pa tjetër ekzistojnë atje, dhe që përcillen qartë në diskutimet e gjalla dhe herë herë edhe të zjarra të atyre pjesëmarrësve të pakët në Komisionin e Hartimit të Kushtetutës. Nuk ka dyshim se Kushtetuta e sotme ka ide, qëndrime dhe parime të rëndësishme, që pasurojnë traditën kushtetuese vendase. Dhe se tre ndër juristët më të aftë morrën pjesë në hartimin e saj.

Por një analizë krahasimore e procesit kushtetues që solli në hartimin dhe miratimin e Kushtetutës së vitit 1998, si dhe disa nga zgjidhjet kryesore që ajo i nguli në ngrehinën kushtetutese të shtetit të shqiptarëve të përcjellin në përfundimin se Kushtetuta e vitit 1998 përbën një hap prapa në historinë e shtetit dhe së drejtës të periudhës së Shqipërisë pas-komuniste.

Me ndihmën e agjencisë IREX, autori këtij shkrimi kreu një studim të imët të Kushtetutës së vitit 1998 duke e krahasuar me Kushtetutën e Përkohëshme që përfaqësohet me Ligjin për Dispozitat Kryesore Kushtetuese i vitit 1991 si dhe ligjet që e plotësuan atë. Studimi gjëndet i botuar në gjuhën angleze në faqen e IREX tek <http://www.irex.org/programs/stg/research/07/Alibali.pdf>

Nga pikëpamja e procedurës së hartimit dhe miratimit, Kushtetuta e Përkohëshme qëndron cilësisht më lart dhe më e sigurtë se sa ajo e vitit 1998 për këto arsye:

– ajo u hartua, u diskutua dhe u miratua nga një kuvend i dalë prej zgjedhesh që nuk ishin kontestuar nga pala humbëse (*krahaso me klimën politike zgjedhore të pas-1997*);



– ajo ishte gjithëpërfshirëse, pasi siguroi pjesëmarrjen e plotë të opozitës dhe miratimin përfundimtar të saj me bashkëpëlqim (*krahaso mospjesëmarrjen e opozitës në të gjithë procesin kushtetues të vitit 1998 dhe miratimin e saj me shumicë votash, pa bashkëpëlqimin dhe pjesëmarrjen e opozitës*);

– ajo ishte një produkt kryesisht dhe thelbësisht vendas, i hartuar nga juristë dhe politikanë vendas (krahasojë me shartimet e shumta juridike të huazuara nga tradita kushtetuese të shumë vendeve të tjera).

Nga pikëpamja e zgjidhjeve kushtetuese-institucionale të imponuara (*përdorim këtë term pasi vetë dokumentacioni përkatës i botuar vërteton se mjaft syresh u "sugjeruan" dhe u "pranuan" në emër të disa parimeve të përgjithshme apo standardesh të mjegullta ndërkomëtare të pa mbështetura në praktikën kushtetuese ndërkomëtare dhe krejtësisht jashtë traditës dhe realitetit shqiptar*), përsëri Kushtetuta e vitit 1998 qëndron më poshtë se ajo paraardhëse.

Ndër shembujt më flagrantë të kësaj shmangieje kushtetuese mund të përmendim revolucionin që Kushtetuta e vitit 1998 solli në strukturën dhe kompetencat e pushtetit vendor. "Të ndryshosh strukturën e pushtetit lokal ... për mua do të thotë t'i heqësh fitlin ndonjë detonatori", do të deklaronte me vendosmëri deputeti Pandeli Majko në një nga seancat dëgjimore të Komisionit të Hartimit të Kushtetutës. [Mbledhja e 8 majit 1998 e Komisionit Kushtetues. Debatimi Kushtetues, V. I. OSBE, Tiranë, 2006, f. 288]

Krijimi dhe ngurtësimi me kushtetutë i strukturës së re të qarqeve (apo rajoneve a kantoneve) në dëm të rretheve – që ishin njësi krejtësisht demokratike, të cilat i shërbenin më së miri qytetarëve dhe përputheshin tërësisht me traditën kushtetuese vendase – u ndërmor nga ana e Komisionit të Hartimit të Kushtetutës në mënyrë të gabuar dhe të shpejtuar proceduralisht. Ky shpartallim kushtetues i strukturës së pushtetit vendor ka sjellë sot pasoja tejet të rënda në ushtrimin e demokracisë vendore, në prishjen e raporteve dhe kompetencave ndërtuese midis qytetarit, pushtetit vendor dhe atij qendror si dhe ka qenë faktor themelor në rrëmujën dhe kaosin e pashembullt ndërtimor dhe urbanistik që ka pllakosur mbarë Bregdetin dhe Ultësirën Perëndimore të Republikës së Shqipërisë.

Praktika e sotme kushtetuese në Shqipëri tregon se Kushtetuta e vitit 1998 duhet ndryshuar. Përveç ndryshimit tektonik në strukturën e pushtetit vendor, një sërë zgjidhjesh të tjera të saj janë bërë pengesë për zhvillimin e një shteti demokratik, të fortë dhe me dinjitet. Marrim për shembull, mënyrën e zgjedhjes së Presidentit, kompetencat e kufizuara të Kryeministrit në ndryshimin e kabinetit të tij, dualizmin e panevojshëm midis të drejtës së besimit si e drejtë themelore individuale me të drejtat

e tejzgjerruara të komuniteteve fetare, ngurtësimin me Kushtetutë të organeve dhe institucioneve që normalisht duheshin krijuar e autorizuar me ligj, si për shembull Avokati i Popullit, Komisioni i Kontrollit të Shtetit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kodifikimi i panevojshëm i disa parimeve dhe institucioneve të zakonshme ndërkohë që një kushtetutë normalisht ndërthen vetëm parimet dhe normat themelore të shtetit, etj.

Çështja nëse Kushtetuta do bërë nga e para, domethënë e re, apo duhen bërë vetëm disa ndryshime apo amendamente të saj është diçka që i takon sferës politike për t'u vendosur.

Mirëpo ajo çka mund të nxirret si mësim nga praktika e hartimit dhe miratimit të Kushtetutës së vitit 1998 është se procesi i hartimit dhe miratimit të Kushtetutës së re të Shqipërisë duhet të jetë detyruesisht një proces endogjen, i ndërmarrë, i udhëhequr dhe zbatuar nga vetë shqiptarët.

Para disa kohësh pata hedhur idenë e një Këshilli të Urtësh për hartimin e kushtetutës, i cili të thirrej nga Presidenti dhe të punonte për të përcaktuar rregullimet apo përmirësimet që ka nevojë kushtetuta. Këshillit do të duhej t'i siguroheshin kushtet, mjetet dhe sidomos qetësia e nevojshme.

Këshilli i të Urtëve mund të mos ketë më shumë se shtatë apo nëntë vetë, ku gjysma të jenë juristë të shquar dhe gjysma tjetër të jenë përfaqësues më në zë nga sfera të tjera shoqërore. Do të ishte shumë e rëndësishme që në krye të Këshillit të të Urtëve të ftohej shkrintari i shquar Ismail Kadare.

Këshillit mund t'i lihet një afat kohor prej gjashtë muajsh, në krye të të cilit ai të paraqesë propozimin për amendamentet e nevojshme.

Ndërsa angazhimi i tërthortë i partive kryesore politike do të ishte disi i nevojshëm, përvoja negative e së kaluarës e bën të papranueshme ndërhyrjen e personave apo entiteteve "të interesuara" në punën e Këshillit. Sa për ekspertët e huaj apo OSBE-së – të cilët mund të ngarendin për të ofruar ndihmë, atyre mund t'u thuhet shkurt "Falemnderit shumë, por nuk kemi nevojë."

I takon më pas Kuvendit dhe popullit që të mbajnë qëndrim për propozimet e Këshillit në ringritjen e Ligjit Themeltar të shtetit si kushtetutë e vërtetë e shqiptarëve, dhe jo si Kushtetuta e sotme që vetëm e tillë nuk është.

The Prediction of Soil Moisture Distribution for a Small Catchment by the Distributed Hydrology Soil Vegetation Model (DHSVM)

ABSTRACT

The soil series applied to a map unit uses ranges for most of the soil characteristics; therefore, inherent variability exists within a soil map unit. The soil map units may include more than one soil series which introduces another source of variability. These shortcomings can be critical when the soil map units are viewed from a watershed perspective and modeling, especially for quantitative assessment of the role that soil characteristics have on soil moisture distribution, interflow, water table depth, and vice versa. The objectives of this research were to: i) evaluate the spatial distribution of soil data based on polygons from order 2 soil survey (SSURGO) and measured values from zero order soil survey; and ii) compare hydrologic indicator predictions using the Distributed Hydrology Soil Vegetation Model (DHSVM) for zero order and order 2 data input. The use of average, minimum, and maximum ranges of soil characteristics as inputs to the DHSVM based on SSURGO indicated significant differences in the predicted soil moisture distribution patterns. This is expected given the inherent variability of the soil characteristics by the order 2 soil survey. The DHSVM prediction of soil moisture distribution using soil characteristics based on zero order soil survey was more closely related to the geomorphic characteristics of the catchment compared to the order 2 soil survey. The spatial distribution of the depth to the limiting layer had a major influence on the moisture spatial distribution in the soil profile and water table depth and duration.

Introduction

The Soil Survey was authorized by U.S. Congress with the Agricultural Appropriation Act of 1896 and was later expanded with the Soil Conservation Act of 1936 (Soil Survey Manual, 1993). Early Soil Surveys were conducted to help farmers managing their soils for crop production. They were more qualitative in nature but have become more quantitative with the accumulation of knowledge and introduction of new technologies. The soil concept was gradually widened by determining the soil from a series of pits rather than a single pit. Morphological descriptions were also emphasized and ranges of properties were used to characterize a soil (Marbut, 1935). With the accumulation of knowledge came the need for a system-

atic classification of soils, which lead to the development of various soil classifications systems. Soil Classification in the United States is based on the U.S. Soil Taxonomy.

According to the U.S. Soil Taxonomy *Soil* is defined as "a natural body comprised of solids (minerals and organic matter), liquid, and gases that occurs on the land surface, occupies space, and is characterized by one or both of the following: horizons, or layers, that are distinguishable from the initial material as a result of additions, losses, transfers, and transformations of energy and matter or the ability to support rooted plants in a natural environment". Two major features related to this definition are the development of "horizons" or "layers" related to pedogenesis and the "ability to support root plants" (Boul et al., 1973). The pedogenesis views soils as natural bodies that have evolved with time due to various factors, thus relating historic forming factors to soils characteristics, which in turn are related to their ability to support root plants. Related directly to this definition is the determination of the upper and lower boundaries of the soil and the diagnostic features used to classify soils. The difficulty in defining of the lower boundary (Boul et al., 1973; Soil Survey Manual, 1993; Soil Taxonomy, 1999), has lead to several definitions such as "solum", which considers only the layer that serves as the natural medium for plant growth (Brady and Weil, 1999; Soil Taxonomy, 1999) with a 2 meter arbitrary boundary (Boul et al., 1973; Soil Taxonomy, 1999). "Regolith" has been used often to account for the parent material and the unconsolidated materials beneath the solum that extend to the bedrock or lithological discontinuities (Brady and Weil, 1999).

In addition to pedogenic forming factors The U.S. Soil Classification utilizes concepts such as: "pedon", "polypedon", "soil series" and "map units" to describe the spatial distribution of soils. According to the Soil Taxonomy "pedon" is the smallest body of one kind of soil that represents the nature and arrangement of horizons and variability in the other properties. For practical purposes it can be viewed as a point on the landscape with small spatial boundaries (1m² to 10 m²); therefore the term "polypedon" is used to represent its wider spatial boundaries. However, finding the boundaries of the polypedon on the ground is very difficult. Recognizing this difficulty,

soil scientists have only classified pedons, ignoring their wider spatial boundaries, thus transferring to the pedon all soil properties from a wide surrounding area. The “soil series” concept is a group of soils or polypedons with horizons similar in arrangement and in differentiating characteristics that have a relatively narrow range of characteristics. Some of the indicators commonly used to differentiate soil series are horizons and their characteristics such as kind, arrangement, thickness, structure, color, texture, reaction, consistence, content of carbonates and other salts, content of humus, content of rock fragments, and mineralogical composition, etc. The soil series category is the lowest and most homogeneous category in the taxonomy used in the United States and it serves as the building block for soil map unit that could include one or more soil series. There are more than 20,000 detailed soil series descriptions covering the United States and other U.S. Territories (http://soils.usda.gov/technical/classification/osd/fact_sheet.html). However, the “soil series” concept is not a homogeneous category as it uses ranges for most of the soil characteristics, thus it inherently introduces variability to the soil map units. Each Official Soil Series Description (OSD) contains information about a specific soil, and it also includes ranges in variability for almost all the soil characteristics under the Range in Characteristics section. As an example, Gilpin soil series (Fine-loamy, mixed, active, mesic Typic Hapludults) has ranges for depth to bedrock varying from 50 to 100 cm; solum thickness from 50 to 90 cm; varying depths and textures for different horizons being silt loam or loam (A horizon), silt loam, silty clay loam, clay loam, or their channery analogues (Bt horizons), channery loam or sandy loam (C horizon), and sandstone, shale or siltstone for underlying bedrock. The same could be said for Wellston soil series (Fine-silty, mixed, active, mesic Ultic Hapludalfs). Both soils are present in the study area. Texture is one of the major controlling variables of soil hydraulic properties like hydraulic conductivity and infiltration rate that are both important for soil water movement and storage. Hydraulic conductivity is a highly variable soil property that may vary by 10-fold or more for a particular soil series soil (Soil Survey Manual, 1993). Infiltration rates can also vary with texture and soil type (Dunne and Leopold, 1978) in addition to spatial variability.

The delineation of soil map units takes into account other factors such as: (i) landscapes in which soils occur; (ii) and their predictive behavior under specific land uses (Soil Survey Manual, 1993). The integration of the first two factors into soil map unit design introduces further variability within the map units themselves in addition to the soil series, variability that in most cases does not have a spatial pattern that can be related or predicted by the

landscape or geomorphic features on a watershed level, which depending on the scale could lead to erroneous interpretations. The map units can only convey information about the ranges of soil characteristics on a certain landscape, but it does not provide a spatial characterization of these ranges in terms of their distribution or occurrence on the landscape. As previously mentioned, the depth to bedrock for Gilpin soil series varies from 50 to 100 cm and so does the solum thickness varying from 50 to 90 cm. These ranges may have a great influence on soil water movement and distribution depending on where they occur on the landscape (shoulder versus foot slope for example). These shortcomings can be critical when the soil map units are viewed from a watershed perspective, especially for quantitative assessment of the role that soil characteristics have on soil moisture distribution, interflow, water table depth and viceversa.

The completion of the initial Soil Survey for the entire United States is projected around 2010. Efforts now are being focused on producing digital seamless soil coverage for the continental United States and maintaining the existing soil surveys by incorporating new knowledge. In addition, the use of new digital technologies such as Geographic Information System (GIS), Global Positioning System (GPS), Remote Sensing, and Digital Elevation Models (DEMs) among others have increased the efficiency and the ability of Soil Survey to address the needs for a diverse base of clients including researchers, especially those working on modeling. These developments provide an opportunity for revisiting and addressing some of the issues related to soil series, map units, and their interpretations.

Distributed Hydrology Soil Vegetation Model (DHSVM) is a GIS-based modeling designed for watershed analysis. DHSVM is a physically based, distributed hydrology-vegetation model for complex terrain designed for a wide range of spatial and temporal scales from plot to large watershed at sub daily to daily timescales (Wigmosta et., 1994). The model integrates hydrology-vegetation dynamics (evapotranspiration model, energy balance for snow accumulation and melt, two-layer rooting zone model, and a saturated subsurface flow model) at the digital elevation model (DEM) scale. A distinguishing feature of the model is its ability to redistribute the downslope soil moisture on a pixel-by-pixel basis, which in turn requires the assignment of surface cover and soil properties to each pixel (Wigmosta et., 1994). As spatial distributed model DHSVM has important applications for the interpretation and prediction of the effects of land use land changes on hydrological indicators (Storck et al., 1998).

The size of the SIPAC watershed study area is very small, thus the sub-models used to characterize the hydrology-vegetation dynamics may vary little in space,

except perhaps for the saturated subsurface flow model. Under the model, each pixel exchanges water with its eight neighboring pixels allowing for a quasi three-dimensional subsurface flow. Several assumptions are made to represent the subsurface flow. First, the unsaturated subsurface moisture movement is calculated using Darcy's law, which was derived for saturated subsurface flows only. The model also assumes that for a saturated soil the excess water becomes surface runoff. This assumption may be valid for steeper slopes but perhaps not for smother slopes. The travel time for the surface runoff is calculated based on the flow path and the velocity vectors along that flow path. The calculation of the velocity vector for each pixel is based on upstream drainage area and local slope, which does not allow for downstream infiltration (Storck et al., 1998). The saturated hydraulic conductivity is assumed to decrease exponentially with depth, which could be true for most cases, except for soils that develop cracks (smectitic), or soils with buried horizons and underlying coarser textured layers. Some of these issues can be addressed by providing specific measured parameters at a finer resolution based on detailed surveys of the catchments, which maybe time consuming and expensive. Despite these issues, the DHSVM is a powerful tool for studying spatial distribution of hydrological indicators at finer scales and their relationships with soil properties and morphological features.

The general objective of this study is to quantify the spatial distribution of soil characteristics based on a watershed scale in order to provide better soil interpretations as they relate to beneficial uses. The specific objectives are: (i) demonstrate the advantages of using digital technologies (GIS, GPS) to better characterize the variation of soil properties on landscape and watershed scales; (ii) use the Distributed Hydrology Soil Vegetation Model (DHSVM) to compare soil moisture predictions from a small catchment using minimum and maximum soil range characteristics provided by the Soil Survey.

MATERIALS AND METHODS

The study site is located in Dubois County, Indiana at the Southern Indiana Purdue Agricultural Center (SIPAC) (Fig. 1).

SPATIAL DATA ACQUISITION

Several on-line sources were used to acquire spatial data on terrain and soils. The 5 foot resolution Digital Elevation Model (DEM) data were downloaded from the Indiana Spatial Data Service along with aerial photographs and satellite images for the study area. The Indiana 2005 digital elevation model was created from the 2005 Orthophotography of Indiana (color 1-ft and 6-in resolution) im-

agery that was collected during March and April leaf-off conditions at a minimum resolution of 1-foot statewide. The Coordinate System was Indiana State Plane 1983, Horizontal Datum NAD83; WGS84 Vertical spheroid; Vertical elevation units were in feet with a 5 foot pixel resolution. The file format was ERDAS IMAGINE and geotiff. The DEM was projected in NAD-1983_UTM_Zone_16N in order to change the cell units from feet to meters as required by the Distributed Hydrology Soil Vegetation Mode (DHSVM).

Aerial photographs were from the 2005 Statewide Natural Color Aerial Photos in both TIFF and MrSID format. High resolution tiles images were downloaded and had State Plane Indiana East and West Coordinate System; NAD83 Horizontal datum; a pixel resolution of 1-foot. In addition to the state wide DEM and aerial photos, the high resolution tile image data for tile number 30601168 were downloaded in order to save space and processing time.

Soil data were downloaded from the USDA-NRCS Soil Survey Geographic (SSURGO) database for Dubois County, Indiana as ESRI shape file format. The geospatial reference was North American Horizontal Datum of 1983; Geodetic Ellipsoid Reference System 80. The Soil shape file was re-projected based on the DEM projection.

SPATIAL DATA PROCESSING

Several data transformations were performed using ArcMap toolbox. The watershed boundaries of the study area were delineated using ArcHydro function in ArcGis. Terrain processing functions were followed to generate several layers of hydrological characteristics of the watershed. The 1 meter resolution DEM "30601168_dem_spw.tif" tile was first processed using the fill sinks function to smooth the DEM. Several functions were carried out in the order of : Flow direction; Flow accumulation; Stream Definition; Stream Segmentation; Catchment Grid Delineation; Catchment Polygon Processing; Drainage Line Processing; Adjoint Catchment Processing; Drainage Point Processing; Weighted Flow Accumulation. Each function created a layer that was used as an input for the next function. This set of functions was used to delineate the catchment boundaries based on the DEM. The DEM boundaries were adjusted to the boundaries of the catchment derived from ArcHydro using "Extract by Mask" command under Spatial Analyst Tool. A Mask file in a raster format was created from the DEM generated from the catchment boundaries using "Option" function under Spatial Analyst toolbar in ArcMap. All cell values in the mask raster file within the catchment boundaries were assigned values equal to one, while values outside the mask (-9999) were assigned 0 values. This was accomplished in ArcMap using "Con" command under

Conditional in Spatial Analyst Tools. The mask raster file generated from the DEM was used to generate a vegetation raster file with one land cover type (pasture). Before converting the soil map to a raster format the County Soil Survey map was clipped with the catchment created from the ArcHydro used as a cookie cutter. The soil shape file was also converted to a raster file format, with soil types marked as 1 and 2 representing the number of soil map units within the catchment.

The "Options" command in the Spatial Analyst toolbar in ArcMap was used to assure that the cell size, number of rows and columns, and projections were the same for all raster files. A raster file was also created for soil depths for the soil map units within the catchment. Several raster files were created for minimum and maximum ranges of soil depth to the lithic or paralithic material. Grid files for Mask, Soil, Soil depths, Vegetation, and DEM were converted to Ascii files (txt). The stream shape file for the catchment created during the ArcHydro processing was imported from the geodatabase created by ArcHydro to another folder and transformed to a coverage file to allow the use of ArcInfo in order to make the necessary correction needed for the model simulations.

SOIL DATA PROCESSING

Data on the Soil Series mapped in the project area were acquired from published Dubois County Soil Survey (USDA-NRCS, Soil Survey of Dubois County, Indiana, 1980) and Soil Survey Geodata base (SSURGO). The soil series mapped within the boundaries of the catchment were Wellston and Gilpin series (Figure 1).

The soil series descriptions were downloaded from the USDA-NRCS Official Soil Series Descriptions (OSD) web-site. Ranges in soil characteristics were derived from the Pedons described in the Soil Survey Book and Official Soil Series Descriptions (OSD) provided by the USDA-NRCS Soil Survey. According to the Soil Survey Book, soils within the catchment boundary were classified as Gilpin and Wellston Series, each occupying a certain portion of the catchment. The Taxonomic Groups for the soils were:

Wellston - Fine-silty, mixed, active, mesic Ultic Hapludalfs;

Gilpin - Fine-loamy, mixed, active, mesic Typic Hapludults.

Soil properties from the Pedons described in the Soil Survey were assigned to each pixel within the polygon that each soil series occupied in the catchment. Model simulations were performed for minimum and maximum ranges in soil depth to the bedrock (Table 1).

Soil Series	Range			
	Wellston		Gilpin	
Soil Characteristics				
Solum Thickness (cm)	81	140	46	91
Depth to Lithic (cm)	102	183	51	102
Horizons	Texture Classes			
A	sil, sicl		sil, l	
Bt	sil, sicl		sil, l, cl, sicl	
C	ch, vch, extch		scl, cl, sal	
	gr, vgr, extgr, sil			
R	sandstone		shale, siltstone, sandstone	

Table 1. Ranges in characteristics for the soil series within the catchment boundaries.

ch – channery;
vch and extch – very and extremely channery;
gr – gravelly; vgr and extgr – very and extremely gravelly;
sil – silt loam; sicl – silty clay loam;
scl – sandy clay loam; cl – clay loam; l – loam;
sal – sandy loam;

DISTRIBUTED HYDROLOGY SOIL VEGETATION MODEL

The Distributed Hydrology Soil Vegetation Model (DHS-VM) (Wigmosa, 1994) was used to simulate soil moisture distribution within the boundaries of the catchment. In order to simulate soil moisture variations based on the variations in ranges for the soil characteristics, DHSVM Input files were created (Table 2).

Two data sets were created for the depth to the lithic contact based on the minimum and maximum soil ranges that were used as input to the Distributed Hydrology Soil vegetation Model (DHSVM). Values for lateral and vertical conductivity were assigned based on the texture class using approximations from (Maidment, 1993). Other soil




Figure 1. Location of the Study Area.

Soil Parameters	Units	Soil Layers		
		1	2	3
Soil Type				
Lateral Conductivity	m sec ⁻¹	4.55E-04	2.55E-04	7.50E-05
Exponential Decrease		3	3	3
Maximum Infiltration	m sec ⁻¹	6.00E-05	6.00E-05	6.00E-05
Surface Albedo		0.1		
Soil Layers Thickness	m	0.254	0.381	0.175
Porosity	cm ³ cm ⁻³	0.45	0.52	0.52
Pore Size Distribution		0.28	0.24	0.24
Bubbling Pressure		20.76	32.56	32.56
Field Capacity	cm ³ cm ⁻³	0.33	0.33	0.33
Wilting Point	cm ³ cm ⁻³	0.133	0.133	0.133
Bulk Density	kg m ⁻³	1520	1560	1650
Vertical Conductivity	m sec ⁻¹	4.55E-05	2.55E-05	7.50E-06
Thermal Conductivity	W m ⁻¹ °C	7.114	6.923	7
Thermal Capacity	J m ⁻³ °C	1.40E+06	1.40E+06	1.40E+06

Table 2. DHSVM Soil Characteristics Input File.

physical properties (porosity, pore size distribution, effective porosity, field capacity, and wilting point) were also assigned in the same manner. Bulk density and soil layer thickness were assigned based on the measured values from the soil pedon descriptions and analysis (<http://Soil-DataMart.nrcs.usda.gov>). Soil layer thickness for A and E horizons were combined for the first soil layer thickness. The same procedure was followed for the Bt horizons and C horizons leading to three soil layers.

DHSVM uses meteorological data like precipitation, relative humidity, air temperature, wind speed, short- and long wave radiation for simulations by creating hourly or daily time series depending on the availability and resolution of the weather data. Weather data for the October-November 1986 period from the nearby weather station were used.

Input Vegetation parameters during the simulation period were based on grass land cover and assumed constant during the simulation.

DHSVM simulations were performed separately for minimum and maximum ranges in soil depth to lithic generating a set of soil moisture distribution maps. Output maps were in binary format and were converted to raster format for displaying into ArcMap.

The aggregated data output text file with hourly and daily changes in soil moisture distribution were converted to excel spreadsheet for further analysis.

Soils: DHSVM

(DHSVM) is a GIS-based model designed for watershed hydrology analysis. DHSVM is a physically based, distributed hydrology-vegetation model for complex terrain designed for a wide range of spatial and temporal scales from plot to large watershed at sub-daily to daily timescales (Wigmosta et al., 1994). A distinguishing feature of the model is its ability to redistribute the soil moisture on a pixel by pixel basis, thus requiring assignment of soil properties to each pixel. ArcGIS software was used to process the Digital Elevation Model (DEM) which is necessary for running the model. Other spatial data such as soil polygons, aerial photos, topographic sheets were processed in ArcGIS. The Soil Shape file downloaded from SSURGO was converted to a raster format. Two separate raster files were created for the minimum and maximum soil depth to the lithic or paralithic contact. Soil properties from Soil Data Mart were used as input values for each pixel within each soil map unit for both raster files. Weather data were provided by a nearby weather station. The model was simulated for a 12 month period from October 1, 1995 to September 30, 1996 on a hourly time basis. Model outputs were soil moisture for three soil layers: A, E and AE horizons (Soil_Layer_1/Top); Bt horizons (Soil_Layer_2/Second); and BC/C horizons (Soil_Layer_3/Third), and water table depth.


The soil moisture from the DHSVM output as Volumetric Water Content (VWC) was also expressed as percent moisture saturation of the total soil pore volume.


STATISTICAL ANALYSIS

A paired t-test analysis was used to compare average soil moisture for all three soil layers and the whole soil profile moisture for minimum and maximum ranges for depth to lithic contact.


RESULTS AND DISCUSSIONS

Soil pore moisture saturation was significantly higher for the minimum depth to lithic for all three soil layers and the weighted soil profile moisture ($p < 0.01$) than for the maximum depth (Fig. 2).





Soil pore moisture saturation showed a great seasonal variability and great differences between minimum and maximum depth to lithic. The moisture saturation for the minimum depth showed a greater seasonal variability compared to the maximum depth (Fig. 3). The volumetric soil moisture content distribution on the catchment showed differences between minimum and maximum depth to the lithic (Fig. 4).



The differences in predicted volumetric water content (VWC) between minimum and maximum depth to lithic increased with soil depth and were more pronounced for the deeper soil layer. During the high precipitation month, the differences in VWC were less and showed a more uniform pattern within the watershed. During the low precipitation

month the differences in VWC were greater, especially for the deeper soil layers, and this was somewhat opposite of the high precipitation month (Fig. 4). This has implications for soil pedogenic processes and development of redoximorphic features as they are influenced by water.

CONCLUSIONS

The observed differences in the predicted soil moisture distribution between minimum and maximum soil depths from this preliminary research emphasize the importance mapping the spatial distribution of soil properties on the landscape. Soil maps would be more useful if based on a continuum, like DEM, rather than discrete boundaries. Models like DHSVM can potentially be used to predict the spatial distribution of soil saturation conditions and other soil interpretations on landscape and watershed scales as well as on a site-specific scale, given the soil data is provided on a continuum. More work will be needed in the future to collect field data in order to validate the DHSVM.

BIBLIOGRAPHY

- Boul, S.B., F.D. Hole, R.J. McCracken, and R.J. Southard. 1973. *Soil Genesis and Classification* (4th Edition). Brady, N.C., and R.R. Weil, 1999. *The Nature and Properties of Soil* (10th Edition). Dunne, T, and L.B. Leopold, 1978. *Water in Environmental Planning*. Maidment, D.R. (ed) 1993. *Handbook of Hydrology*, McGraw Hill. Storck, P, L. Bowling, P. Wetherbee, and D. Lettenmaier, 1998. *Application of a GIS-based distributed hydrology model for prediction of forest harvest effects on peak stream flow in the Pacific Northwest*. Hydrological Processes. 12, 889-904. United States Department of Agriculture. Natural Resources Conservation Service (USDA-NRCS) Agriculture Handbook Number 436. *Soil Taxonomy. Basic System of Soil Classification for Making and Interpreting Soil Surveys*. Second Edition, 1999, By Soil Survey Staff. United States Department of Agriculture Natural Resources Conservation Service (USDA-NRCS) Handbook Number 18. *Soil Survey Manual*, 1993. By Soil Survey Staff: http://soils.usda.gov/technical/classification/osd/fact_sheet.html United States Department of Agriculture, Geospatial Data Gateway: <http://datagateway.nrcs.usda.gov/> Indiana Spatial Data Service. <http://www.indiana.edu/~gisdata/index.html> United States Department of Agriculture. Natural Resources Conservation Service (USDA-NRCS). Soil Survey Geographic (SSURGO) database for Dubois County, Indiana: <http://SoilDataMart.nrcs.usda.gov>

Koha dhe hapësira janë dy nga përbërësit kryesorë, pa të cilët nuk mund të mendohet endja e një subjekti artistik. Për rolin e rëndësishëm të tyre që kanë në organizimin dhe funksionimin strukturor të një veprë letrare është e domosdoshme edhe përputhja ose shpërputhja, mandej gërshetimi dhe harmonizimi ciklik a linear ose i kombinuar i fabulës dhe subjektit. Me fenomenin e kohës në veprën letrare kanë shkruar shumë autorë (Bahtini, Bali, Barti, Biti, Buti, Gremasi, Hamburgeri, Jausi, Kaleri, Lotmani, Myleri, Propi, Rikeri, Strosi, Uspenski, Zheneti). Meqë narratori dhe personazhi kryesor janë elementë kryesorë të strukturës narrative, është i rëndësishëm edhe hulumtimi, interpretimi dhe studimi i tyre nëpërmjet fenomenit të organizimit të kohës dhe të funksionimit të saj. Në të shumtën e rasteve, në hierarkinë e strukturës narrative, kohës i nënshtrohen edhe narratori edhe heroi kryesor, ndaj edhe organizimi i tyre i nënshtrohet parimit të qëndrimeve dhe të harmonisë së heroit.

Në studimet narratologjike mbisundon mendimi se bota e veprës letrare realizohet në një lojë me kohën, ligjësitë (graviteti, inercia, mosprania e trupit) dhe poetikën e saj (kohën e rrëfimit, kohën e rrëfyer, kohën e jetës). DimENSIONI kohor i veprës letrare transformon kohën e botës së përditshme. Në këtë botë personazhet karakterizohen në mënyra të ndryshme me kohën si përcaktuesin e qenësisë. Ndaj thuhet se struktura e brendshme e veprës letrare është një “performancë” i betejave të ndryshme kundër forcës së palodhshme të kohës. Hapësira e kohës së veprës letrare është hapësirë e psikologjisë, e cila nëpërmjet fabulës bëhet pjesë përbërëse e totalitetit të kohës. Ajo mund të tregohet në mënyra të ndryshme, si nëpërmjet strukturimit të brendshëm, ashtu edhe nëpërmjet përjetimeve të personazhit. Një model si ky i fundit i shërbeu Gavril Darës së Ri për endjen e subjektit të poemës së tij.

Nën konceptin kohor të strukturës së veprës letrare dallojmë tri kohë: kohën e rrëfimit – kohën e rrëfyer – kohën e botës së rrëfyer (paraqitur). *Koha e rrëfyer* përcaktohet nëpër kohëzgjatjen që i është kushtuar elementëve të ndryshëm të subjektit në raport me kohëzgjatjen që ata kanë në fabulë, kurse *koha e botës së paraqitur* është e lidhur kryesisht me interpretimin e veprës në kuptim “të tërheqjes” – mashtrimin të lexuesit në botën e tij.

Teknika narrative, sipas përbërjes së vet nuk është

asgjë tjetër veçse vërtetim i fakteve jetësore në kohë, të cilët organizohen në harmoni me format e vetë jetës dhe të ligjësisë të kohës së saj. Rrëfimi është pjesë përbërëse, të cilin narratologjia e definon si tekst në të cilin një instancë në një mënyrë të veçantë rrëfen fabulën e prezantuar. Koha për rrëfimin ka rëndësi kryesore, sepse ngjarjet gjithmonë zënë një kohë dhe radhiten sipas një rendi, i cili sipas parimit të vet parasheh suksesionin në kohë. Kjo radhitje mund të jetë identike me fabulën, por mund t’i ketë edhe shmangiet e veta, siç ndodh me poemën *Kënga e sprasme e Balës të Gavril Darës së Ri*, ku gërshetohen dy kohë të shkuara. Ndaj edhe kemi shmangie të subjektit nga fabula.

Thuhet se ndjenjën e kohës e kemi sipas ngjarjes, kurse ngjarja është e mundshme vetëm si lëvizje në hapësirë. Ndaj koha dhe hapësira matematikisht janë dy kategori të pandashme. Lëvizja në hapësirë gjithmonë është edhe lëvizje në kohë. Vetë ngjarja është kalim nga një gjendje në një gjendje tjetër, e cila si e tillë rregullisht nënkupton suksesionin në kohë. Rrëfime pa ngjarje nuk ka. M. Bal-i ngjarjen e përcakton si *kalim nga një gjendje në një gjendje tjetër të kushtëzuar ose përjetuar nga aktori* (Bal, 2000: 143).

Poema *Kënga e sprasme e Balës* në rrafshin përmbajtësor nuk përpunon një temë të mirëfilltë, por dy tema kryesore dhe tre motive: dashuria ndaj atdheut dhe dashuria e dy kryepersonazheve të poemës, Nikut dhe Marës, si dhe motivi i tradhëtisë, si lajtmotiv që shoqëron këto dy tema kryesore. Ato materializohen me një fabulë lineare, ku ngjarjet përcjellin njëra-tjetrën dhe të gjitha bashkarisht krijojnë një tërësi të veçantë dhe unike tematike-motivore.

Rrëfimtari nuk bën ndonjë hyrje të veçantë, si është traditë në vjershërimet e kësaj natyre, por drejtpërdrejt depërton në rrëfim dhe menjëherë përcakton edhe temën kryesore. Në tri vargjet e para: *Mori Bijë, bijë e Lalës, / Moj e bukur, e mëritur, / Pse më siell ndër mend të shkuarën* njoftohemi se, që në nismë të narracionit, Gavril Dara, kërkon ta vendosë përshkrimin e vet në rrethana të atilla përshkrimore të cilat teknikisht do t’i përaftronin motivet e dy kohëve të largëta në një pikë të përbashkët, që brenda vetvetes ta luajnë rolin e pikëbashkimit brendapërbrenda të dy kohëve kundërshtarë: *të shkuarës* dhe *të ardhmes*. Pikëtakimin e këtyre dy kohëve të largëta e paraqet *koha*

e *tanishme*, e cila fuqizohet në praninë e kohës së Balës (dyzet vjeta pas zhvillimit të ngjarjeve) dhe të vetes së fshehur të autorit (në shekullin e nëntëmbëdhjetë).

* * *

Është e ditur se Gavril Dara Nipi me poemën e vet i përket qarkut të krijuesve që trajtojnë tema, të cilat i takojnë të keqes dhe të mirës, trimërisë dhe tradhëtisë, lumturisë dhe vuajtjes, dashurisë dhe urrejtjes. Të gjitha janë të pranishme në opusin e tij, zënë hapësira qiellore dhe tokësore dhe përmes dashurisë së dy të rinjve (Nik Petës e Marës) përtheksohet më shumë dashuria ndaj atdheut të të parëve. Kjo është shpresa, që është e pranishme kudo.

Fabula është krejt e thjeshtë: Dy të rinj Nikë Peta dhe Pal Golemi dalin të fitojnë nam. Rruga i qet në Lalë, ku takojnë Marën dhe të atin e saj Kaurin. Prej aty rekrutohen në ushtrinë e Skënderbeut, ku një natë, derisa Bala bënte roje arrin plaku Harun dhe i njofton se Ballabani me një ushtri është nisur për në Lalë ta marrë Marën dhe ta shpjerë në harem e sulltanit. Nik Peta vullnetarisht obligohet të ndeshet me Ballabanin dhe ta shpëtojë Marën, me të cilën edhe martohet. Por menjëherë kthehet në front. Pason beteja e Valikalit ku vdesin të dy trimat. Vdes dhe Mara nga dhimbja dhe shqetësimi. Gjithçka që nga kjo kohë i ka mbetur Balës është kujtesa e dhimbshme për këtë dashuri tragjike. Atë e mban shpresa se në të ardhmen do të agojë një ditë e lumtur.

Skema temporale e narracionit është mbështetur në rrëfimin me paraecje, por nga perspektiva prapaecëshe (retrospektive) e narratorit. Pra, narratori ngjarjet i paraqet në drejtim të rrjedhës së ndodhisë ose progresit. Ndodhitë e jashtme janë vendosur në një hapësirë kohore të ngushtë. Monotonisë së paraecjes shkrimtari i shmanget me fluturimet e kohëpakohshme retrospektive kah ajo që ka ndodhur dhe ky retrospekcion buron nga përmbajtja e vetëdijes së fokalizatorit të brendshëm. Fiksimi objektiv kohor është i redukuar dhe përparësi i jepet kohës subjektive të cilën e tregon suksesivisht.

Në rrafshin paradigmatic të poemës është ngritur opozicioni i vetëllojshëm midis kronotopit real, të rregullt dhe të mbështetur në parimet logjike; dhe të një kronotpi tjetër, metafizik, i cili mbështetet në parimet iracionale, d.m.th. në perceptimin e “matur” të kohës. Sinkronikja e pozitës vrojtuese është siguruar me përdorimin e pëcaktimeve të kohës (tani – dikur).

Që në fillim të poemës takojmë diferencimin e dy dimensioneve kohore: narracionin e tashmërisë dhe narracionin e kalueshmërisë (*Pse më sjell në mend të shkuarën*). Ky procedë i ndarjes së kohës narrative është i rëndomtë në rastet kur rrëfëhet sipas kujtesës. Kështu ngjet edhe te Gavril Dara i Ri. Poemën e rrëfen “rrëfimtari

i gjithëdijshëm”. Në të është i pranishëm mbisundimi i fokalizatorit të brendshëm. Ky FB funksionon si entitet krejtësisht i ndarë, bile edhe me ligjërimin e vet. Gjithçka në poemë udhëheq kah Nik Peta e Mara, personazhet e saj kryesorë.

Fjalinë e veçuar *Mori Bijë, bijë e Lalës*, shkrimtari e ka përdorur sikur një refren keqsjellës. Kujtesa shndërrohet në ligjërim. Shkrimtari me zëvendësimin cilësor të foljeve arrin efekt dinamik, i cili njëkohësisht kombinohet me gërshetimin e rrafsheve hapësinore vertikale. Me këtë fiton *ligjërim të përhershëm, ligjërim vitesh, ligjërim të heshtur*, në të cilin ndryshohet komunikimi i të gjitha rrafsheve. Radha kohore prospektive shumë shpejt ndërpritet me shprehjen retrospektive të zërit të Nikut e të Marës, të cilët shpjegojnë në detaje zhvillimin e dashurisë së tyre.

Me subjekt dhe fabulë nënkuptohet distinkcioni që ia japin formalistët. Fabula është rrjedha kronologjike (shkak – pasojë) e ngjarjeve në realitet, e cili i nënshtrohet subjektit si përpunim autorial i tekstit. Domethënë në fabulë është koha, kurse në subjekt konstruksioni letrar i kohës. Marrëdhëniet midis fabulës dhe subjektit strukturalistët i merrnin si marrëdhënie midis rrëfimit dhe diskursit.

* * *

Ngjarja mund të ketë tri kategori të vetat, të cilat manifestohen ndryshe në tekstin narrativ. **Ndryshimin, përzgjedhjen dhe konfrontimin.** Bal – i thotë se në proces mund të dallohen tri faza: *mundësia* (realiteti), *ngjarja* vetë (realizimi) dhe *rezultati* (përfundimi i procesit). Këto faza mund të kombinohet midis tyre dhe gjatë këtij procesi teksti mund të ketë zhvillim linear të fabulës, por edhe radhitje komplekse në të cilën gërshetohen forma të ndryshme. Sipas kësaj ngjarja e Balës i përket tipit të ngjarjeve që i përshtaten identitetit të personazhit.

Si duket në këtë parim të fundit të procedimit të ngjarjes nga M. Bal-i, mund të përfshihet edhe interpretimi i ngjarjes nga Jauss-it (Beker, 1985: 281-301). Ngjarja në tekstin letrar, konsideron Jauss-i, varet nga realizueshmëria te lexuesi. Në tekstet romantike ngjarja mbështetet në një numër zbrazëtirash të rëndësishme, të cilat lënë lexuesin të mendojë. Ndaj Bahtin-i, ka pasur të drejtë kur thoshte se ngjarja është e shpjegueshme vetëm nga perspektiva e tërësisë. Ngjarja, thotë Jauss-i, është e lidhur me kohën subjektive, psikike të pjesëmarrësit të ndodhisë historike. Edhe sipas definicionit strukturalist të Lotmanit (Lotman, 1976), ato paraqesin shmangie, transformim ose mohim të strukturës, e cila vendos pritjen.

* * *

Raporti i kohës rrëfimore dhe i kohës së rrëfyer ndriçon edhe pozitën dhe rolin e narratorit në veprën letrare. Narratologjia këtu dallon prespektivën dhe zërin.

Perspektiva ka të bëjë me pikëpamjen e rrëfimitarit, kurse zëri me vetë aktin e rrëfimit, atë që rrëfen dhe atë të cilit rrëfimi i atribuohet. Kjo është pozita e narratorit brenda kohës, ku janë të mundshme kombinime të ndryshme midis kohës së rrëfimit dhe kohës së rrëfyer. Autori kohën mund ta llogarisë nga pozita e ndonjë personazhi ose nga pozitat e veta. Kështu, Gavril Dara i Ri që në fillim të poemës së tij boshtin temporal e ka vendosur nga pozita dhe perspektiva e Balës, që më pas, kur rrëfimi i bartet Nikut ose Marës, narratori pranon pikëvështrimin e tyre. Në këtë mënyrë narratori mund ta ndryshojë pozitën e vet, duke marrë këndvështrimin herë të njërit e herë të personazhit tjetër, por mund ta shfrytëzojë edhe pozitën e vet kohore. Kjo mundësi e kombinimit të këndvështrimit përcakton mundësitë e ndërlikimit të strukturës temporale, me këtë edhe të ndërlikimit të kompozicionit të poemës.

Domethënë, pozitat e ndryshme kohore mund të kombinohen në mënyra të ndryshme. Në poemën e Gavril Darës së Ri pozita ndërrohet në mënyrë succesive nga ngjarja në ngjarje – herë nga këndvështrimi i Balës e herë nga këndvështrimi i Nikut ose Marës. Përshkrimi i episodit të fundit në këngën e 9-të jepet njëkohësisht në dy pozita dhe me këtë rast nuk paraqitet si rezultat i tërthorësisë, por si sintezë e këndvështrimeve të ndryshme, të derdhjes së tyre në një pikë unike.

Është krejtësisht e qartë se brenda problemit të temporalitetit autorin e takojmë jashtë tekstit. Atë e takojmë para së gjithash në kompozicion. Në këtë ngrehinë, e cila kushtimisht mund të quhet e jashtme, merret parasysh koha e rrëfyer, koha e lexuesit dhe koha e krijuesit të veprës, d.m.th. ngritet ndikimi i ndërsjellë midis botës së rrëfyer dhe rrëfyesit, kohës së rrëfyer dhe kohës së rrëfimit.

Letërsia nuk është mimetike në kuptimin e kopjimit të realitetit, por është art mimetik në kuptimin e transformimit të realitetit. Asnjë sferë e veprimtarisë njerëzore nuk e prek jetën në atë masë sa e prek arti. Fizika dhe matematika, biologjia dhe psikologjia, historia dhe filozofia vetëm e prekin jetën, por nuk e rrëfejnë. Vërtetësia e botës së fiksonit nuk matet me ngjashmëritë e botës reale, fiktive, po me funksionimin e saj.

Paul Riccoeur-i dhe Mihail Bahtin-i, duke folur në dy mënyra të ndryshme për këtë çështje, ishin të mendimit se në zhanret rrëfimorë ajo që nuk është në kohë nuk mund të rrëfëhet. Bahtin-i “lidhjen e ndërsjellë qenësore të marrëdhënieve artistike kohore dhe hapësinore të miratuara në letërsi” i quante “kronotop” (Bahtin, 1989: 193). Ai është i mendimit se shenjat e kohës zbulohen në hapësirë, kurse hapësira i jep kuptim dhe matet me kohën. Paul Riccoeur-i, këtë problem u përpoq ta shpjegojë me anë të tri shkallëve të Mimesisit, si ai e quante “kodin”, në të cilin kemi artikulin trishkallor të informatës artistike.

Përkundrazi analiza narratologjike e Mike Bal-it u thellua në shkaqet e temporalitetit në tekstin rrëfimor, që Bahtin-i e shpjegonte me “pasojnë” e strukturës temporale.

* * *

Pra, që në fillim të vjershërimit të Darës ndeshemi me dy temat kryesore, si dhe melajtmotivin e tyre dhe ato vendosen brenda dy kohëve rrëfimorë – koha e ngjarjes – si e shkuar dhe koha e Balës – si kohë e tanishme e fokalizatorit, brenda së cilës realizohet veprimi i këtij konteksti letrar. Këto dy kohë brenda vetëvetes apostrofojnë temat kryesore dhe bartëse të veprimit dhe rreth tyre shtjellojnë subjektin e tërësishëm të poemës. Koha e ngjarjeve – ajo e Nikut dhe Marës, si kohë e shkuar dhe koha e fokalizimit të Balës, si kohë e tanishme ndërthuren midis tyre dhe tentojnë të përfshihen në rrjedhat e kohës së ardhme dhe të trija bashkarisht të funksionojnë si realizim poetik në kohën e bashkëkohësisë së Darës. Tri kohët rrëfimorë të vjershërimit të Darës janë të lidhura ngushtësisht midis tyre, e plotësojnë njëra-tjetrën, edhe pse jo në mënyrë proporcionale dhe kushtëzohen prej njëra tjetrës, sipas parimit të shkak-pasojës.

Kështu koha e Balës fokalizator kushtëzohet prej kohës së Nik Petës dhe Marës, kurse e kundërta, koha tyre nuk kushtëzohet nga koha e Balës. Kjo ngjet për arsye të varshmërisë së ndërsjellë **shkak pasojë** dhe raportit njëdimensional të kohës së Balës. Ndaj edhe mund të thuhet se ndërsjellshmëria kohore nuk ekziston, sepse ato janë ndërtuar në një drejtim sipas kriterit të varësisë zinxhirore që do të thoshte se koha e Balës varet nga koha e Nikut dhe Marës, ashtu si koha e ardhmërisë që varet nga të dyja. Në këtë kontekst të dy kohët rrëfimorë tentojnë dhe varen prej kohës së pritjes – të ardhmërisë.

Në këtë diskurs të ndërtimit të rrëfimit takojmë edhe qëndrimin e autorit ndaj mënyrës së koncipimit të veprimit poetik, i cili me pjesëmarrjen aktive të rrëfimitarit Balë, si fokalizator i subjektit, e kushtëzon rrjedhën strukturore të kompozicionit të poemës. Kjo është pjesëmarrje e realizuar në formë të drejtpërdrejtë dhe përdoret për ta shprehur mallin për atdheun dhe dhimbjen për fatet tragjike e fatale të personazheve, të cilat si kërkesa poetike vihen në funksion të përtheksimit të krenarisë kombëtare të periudhës historike të Motit të Madh. Kjo mënyrë e ndërtimit të veprimit poetik paraqitet edhe si nevojë e përqaimit të programit të Rilindjes Kombëtare. Ajo kushtëzohet nga ardhmëria e funksionimit të tekstit poetik dhe del si nevojë e shprehjes së kriterit të theksuar institucional të konceptit të artit në përgjithësi, të letërsisë e të veprës letrare, në veçanti, si dhe i miratimit dhe i afirmimit të tyre nga Gavril Dara i Ri si domosdoshmëri.

Njëra kohë është koha e Balës, respektivisht koha e tashmërisë së Darës, e cila praktikisht materializohet në

tri vargjet e njohura që përsëriten në fillim dhe në fund të vjershërimit, me të vetmin ndryshim se në fillim pëndoret koha e tashme *Pse më sjell ndër mend të shkuarën?*, kurse në fund e kryera e thjeshtë *Pse m'kujtove motnë e shkuar?*. Pjesa tjetër e ngjarjes së vjershërimit zhvillohet në kohën e shkuar, sepse ai si rrëfimtari, në tërësi e rrëfen veprimin e poemës. Megjithatë, në disa këngë Bala distancohet nga përshkrimi i ngjarjeve, atëherë rrëfimin, pra fokalizatori të ngjarjes bëhen vetë personazhet: Niku në këngën e tretë dhe të katërt (të pjesës së parë) dhe Mara në pjesën e parë të këngës së dytë (të pjesës së tretë) dhe në këngën e parë (të pjesës së katërt), në tërësi.

Tema e dashurisë së Nikut dhe Marës dhe krejt ngjarja e përshkruar në poemën *Kënga e sprasme e Balës* i krijon kushte narratorit ta zbatojë teknikën e montimit e të ndërldhjes së ngjarjeve që kanë ndodhur në një kohë dhe në një hapësirë të caktuar. Ndaj duke përdorur teknikën përshkrimore të përfshirjes së vetes në kohën e rrëfyer, ai do ta rrëfejë atë edhe si kohë të veten, në bashkëkohësinë e tij, por edhe si kohë të bashkëkohësisë së personazheve dhe me të dyja bashkarisht, ta ndërtojë tërësinë kohore të poemës. Kjo teknikë përshkrimore i krijon kushte të përshtatshme për konkretizimin dhe ta vendosjen e fabulës së poemës në një hapësirë konkrete, në të cilën do të zhvillohet edhe subjekti i saj. Sjellja e një veprimi që ka ndodhur në një kohë të shkuar në bashkëkohësinë e personazhit, në kohën e tanishme, i imponon narratorit përdorimin e *analepsës së jashtme*.

Ndërfutja e të tanishmes së Balës, brenda narracionit të poemës, midis të shkuarës dhe të ardhmes, i shërben rrëfimit si mjet ndërldhës. Me të, në formë të kohës së tanishme dëshirohet të shprehet përpjekja e vazhdueshme e njeriut për ta mundur vetminë, monotoninë e jetës. Rrëfimi përgjithësisht ndërtohet në mënyrë të shkallëzuar dhe në dy pjesë. Midis tyre është ndërfutur koha e ardhmërisë, e cila duke qenë e panjohur, është vendosur brenda rrjedhave të dy kohëve të tjera dhe shërben për ndërldhjen e bashkëkohësisë së Balës me angazhimin e tij për ta rrëfyer historinë.

Pika nismëtare dhe përfundimtare e narracionit, e paraqitur në veprimin e poemës dhe në ndodhitë e saj, nuk përkon me koordinatat kohore të të ndodhurave që përshkruhen në këngët në vazhdim. Ajo nuk është vendosur në bashkëkohësi me ndodhitë e përshkuara vijuese, por dyzet vjet më vonë, nga koha e ndodhjes së disa ngjarjeve. Narracioni nis atëherë kur ndodhitë tanimë kanë përfunduar në një distancë më të hershme kohore. Pika nismëtare e rrëfimit është koha, e cila është vendosur në boshtin kohor të jetësisë së Balës, dyzet vjet pas përfundimit të jetës fizike të Nikut, Palit e Marës.

Kështu narracioni në poemë vazhdimisht do të lëvizë nga e shkuara kah e ardhmja dhe, që në fillim *koha e*

rrëfimitarit, si e tanishme, me kohën që rrëfëhet vendosen në pikën qendrore, brenda dy veprimeve: të kohës, në të cilën një ndodhi tanimë *ka përfunduar* dhe të kohës, e cila do të ngajë më vonë, si kohë e strukturës rrëfimore të poemës. Në fillim të veprës koha e rrëfimitarit vendoset si një *analepsë e jashtme*, por në këngën e tretë dhe të katërt të këngës së parë, si dhe në këngën e dytë (të pjesës së tretë) dhe të parë (të pjesës së katërt) shndërrohet në *analepsë të brendshme*. Gërshetimi dhe funksionimi i tyre si kohë të tanishme të Balës, i mundësojnë narratorit t'i paraqesë si pjesë përbërëse të bashkëkohësisë së tij.

Ndaj, koha e ardhmërisë paraqitet si kohë në korelativitet të ndërsjellë me *kohën e shkuar* dhe të dyja bashkë në raport me *kohën e tanishme*, pra me kohën e bashkëkohësisë së Balës, qëndrojnë në pozita të njëjta: sepse si koha e shkuar (e Nikut dhe Marës), ashtu edhe koha e tanishme e Balës synojnë dhe kushtëzojnë ardhmërinë.

Këto elemente përshkrimore të vjershërimit të Darës e bëjnë atë përfaqësuesin tipik të përshkrimit të pasojave. Në këtë kontekst, vetvetiu imponohet konkludimi se motivimi i faktorëve dhe i agensave letrarë është i nxitur dhe i realizuar sipas diskursit *shkak-pasojë*. Ky lloj motivimi është historik.

Dy kohët rrëfimore të Gavril Darës janë ndërtuar dhe zhvillohen në mënyrë paralele, ndërthuren dhe përplotësojnë njëra-tjetrën, kanë rrjedhë të kundërt dhe janë orientuar në drejtime të kundërta. Ndërtimi paralel i shpie në pikëmbërritje të përbashkët. Kështu ato plotësojnë njëra-tjetrën. Sepse *koha e tanishme* e ndërtimit të rrëfimit, si kohë e Balës, pandërprerë tenton të mbërrijë në *kohën e shkuar*, kurse e koha e rrëfyer – koha e Nikë Petës dhe e Marës tenton kah koha e ardhme, gjegjësisht e tanishme nga këndvërtimi i Balës. Prandaj edhe themi se kohët rrëfimore nuk janë ndërtuar në mënyrë të njëjtë, nuk ndjekin kahe të njëjtë dhe nuk tentojnë të arrijnë në kahe dhe pikë të njëjtë.

Njëra pikënisje rrëfimore është ajo e Balës, në të cilën rrëfimi lëviz nga një pikë në tashmëri drejt një pike në kalueshmëri të afërt, në segmentet e kohës historike. Përballë saj është pika tjetër rrëfimore, koha që rrëfëhet. Në të narracioni vazhdimisht lëviz nga kalueshmëria në *tashmëri*, bashkekziston, funksionon dhe gjallëron me të dhe pa të nuk mund të paramendohet qenësia e saj. Pra ajo shkon në drejtim të kundërt: nga kalueshmëria në tashmëri. Por të dyja bashkë tentojnë të arrijnë në një pikë të ardhmërisë – në kohën e lexuesit dhe të zhvillohen paralelisht me kohën e tij, e cila, sipas Rikerit duhet të ekzistojë në paralelizëm kohor midis kohës së rrëfyer dhe kohës që rrëfëhet.

“Dara fare mirë e paraqet veprën si një krijim të Plakut Balë, rapsod i kohës së Skënderbeut. Ky është një invencion për të motivuar dhe për t'i dhënë frymë

më autentike rrëfimit epiko-lirik për luftën dhe fatin e trimave të Skënderbeut. Pas rrëfimit për ngjarjet zbulohet fati i heronjve dhe rravimet e tyre shpirtërore; në pëlhurën narrative të veprës pra shkrihen elementë të eposit kombëtar dhe të dramës njerëzore, që do të bëhej përmbajtja e romanit si zhanër” (Bulo: 70).

* * *

Narratori në rrëfimin historik – thotë Zh. Zheneti fshihet prapa rolit të informuesit neutral, duke marrë kështu funksionin e verifikuesit të fakteve historike. Ai kështu e ngrit tekstin rrëfimor nga karakteristikat e tij nismëtare, sepse shkalla e informimit të tekstit është e lidhur me mungesën e folësit të tij. Ai me sa më pak plotëni që informon aq më tepër fsheh aktin e informimit (Zhenet, 1972/1980: 67). “Largimi i subjektit rrëfimor nga veprimi për të cilin rrëfëhet rezulton pavarësinë jo vetëm të parës, por edhe të fundit” (Culler, 1981: 170). Letërsia sot i nevojitet secilit, por jo në mënyrë të njëjtë (Biti, 1987: 21).

Kur ngjarja rrëfëhet me gojën e personazhit atëherë paraqitet dukuria e *narratorit* si ndërmjetës midis shkrimtarit dhe ngjarjeve për të cilat flitet dhe rrëfimi i distancuar i ngjarjeve të të kaluarës. Ato i paraqet si përjetim vetjak i botës së jashtme.

Narratologjia nismën e vet e ka në gjysmën e viteve të gjashtëdhjeta të shekullit njëzet. Paraardhës janë formalistët rus. Hulumtimi i *diskursit* nga formalistët rus dhe nga strukturalistët francezë, hapi perspektiva të reja në studimet e vjershërimit narrativ: formësimi i kohës dhe hapësirës, radhitja e kompozicionit dhe e të gjitha elementëve, të cilët i shmangen paraqitjes kronologjike dhe lineare ose ciklike e të kombinuar të ndonjë ngjarjeje (RKT: 498-499). Shklovski bënte dallimin midis *fabulës* (ndërtimi themelor i rrëfimit sipas radhës kauzale kronologjike) dhe *subjektit* (përpunimi specifik i fabulës); Proppi paradigmën (sistemin e caktuar të rregullave abstrakte) dhe sintagmën (tërësitë e vogla narrative, në numër të pakufizuar); Klod Levi-Strausi përktheu mitet (lindjen dhe strukturën e tërësive rrëfimore). Duke bashkuar njësitë e ndonjë miti në tërësi lineare, Strosi zbuloi përpjekjet simbolike të zgjidhjes së kundërshtive shoqërore prej të cilave mitet kanë lindur. A. Zh. Gremasi çoi përpara idenë e çifteve binare, duke vërejtur se pranë kundërshtisë themelore ekziston çifti implicit binar, në të cilin mungojnë tiparet e çiftit të parë.

Nismë të vërtetë të narratologjisë konsiderohet numri 8 i revistës *Communications* (1966), me artikullin hyrës të Roland Bartit, në të cilin theksohet se narratologjia në studimin e *diskursit* (përpunimit specifik të gjuhës) e dekonologjizon tekstin. Më 1972 Zh. Zheneti në kuadër të *Figure III* shtron problemin e shhapërimit midis kohës së rrëfimit dhe vetë ngjarjes në tregim dhe debaton për

paraqitjen e kohës (sidomos analepsës ose rindërtimit të të kaluarës), renditjen, përsëritjen dhe shpeshhtësinë. Me *mënyrën* kupton dallimin (si dhe kalimin) midis *mimezës* dhe *diegezës* (tregimit); kurse me *zërin* kupton përputhjen ose nuancat e dallimit midis kohës së rrëfimit dhe vetë tregimit, si dhe me rrafshet rrëfimore (që mund të jenë brenda ose jashtë tekstit) dhe mund të pleksen me personazhin kryesor ose me ndonjë rrëfimtari tjetër (RKT, 499).

Në kontekst të fabulës dhe subjektit narracioni i poemës nis me kujtesën e Balës për ngjarjen që do të bëhet objekt përshkrimor. Për zhvillimin e subjektit në vend që të përdoret rrjedha lineare, kronologjike, meqë kemi të bëjmë me një temë historike, zbatohet rrjedha ciklike. Prishet kronologjia e ecurisë së ngjarjeve. Motivi i historisë së lindjes së dashurisë së Nikut me Marën, në këngën e tretë, jepet me prapaecje nga perspektiva e Nikut, njësoj si përshkruhen bëmat dhe trimëritë e Nikut (në këngën e katërt). Në këtë diskurs Dara i Ri na del si krijues që i “kundërvihet natyrës” bëhet përfaqësues i pikëpamjes së diegezës së Platonit (Biti, 1987: 14) dhe jetëson pikëpamjen e Benvenistit (Benvenisti, 1966/1975: 183), i cili mendonte se në rrëfimet historike koha e ndodhisë është shumë larg kohës së rrëfimit, tashmëria zëvendësohet me të shkuarën dhe krijohet përshtypja sikur ngjarjet i flasin vetes.

Zheneti mendon se hapja ndaj psikologjisë së personazheve të tjerë dhe jo ndaj vetes duhet interpretuar si indicion i fokalizimit, të cilin teksti rrëfimor me kujdes e përdor në formë hipotetike (Zhenet, 1972/1980: 126). Kritikët kanë vërejtur se përdorimi i shpeshhtë i shprehjeve mënyrore (*ndoshta, padyshim, sikurse, më duket, duket*), i mundëson rrëfimtari hipotetikisht ta thotë atë që mund ta vërtetojë për të mos dalë nga fokalizimi i brendshëm – përfundon Zheneti (126). Midis informatës së personazhit dhe gjithëdijes së shkrimtarit gjendet informata e rrëfimtari, i cili disponon me të ashtu si e dëgjon, por e mban vetëm nëse e sheh shkakun e vërtetë për të (128).

Teoria e tekstit rrëfimor (narratologjia) përpiket t'i kuptojë pjesët e përgjithshme përbërëse të tekstit rrëfimor, analizon se si ndonjë tekst rrëfimor arrin përshtypjet dhe përjetimet e veta. Në narratologji besohet se ekziston një rrafsh strukturor, të cilin e quajmë *thurrje* ose *rrëfim*. *Thurrja* ose *rrëfimi* është ngjarja që tregohet, e rregulluar nga një pikë vështrimi me ndihmën e diskursit (pjesëve të ndryshme të rrëfimit). Në narratologji dallimi kryesor është midis *thurrjes* dhe *rrëfimit*, *rrëfimit* dhe *diskursit*.

* * *

Nocionin e fokalizimit në terminologjinë teorike letrare e ka futur Zherar Zheneti në vitin 1972, në *Diskursin e tekstit rrëfimor*. Ai në shkrimet e veta bën dallimin, deri atëherë të paqartë të kriterit, që i përgjigjej pyetjes *kush flet?* dhe *kush shikon?*, edhe pse, ky nocion, për shkencën

e letërsisë, është i njohur edhe më herët.

Përsëri Laboku në veprën *"Arti i romanit"* (1921), analizon këndvështrimet e autorit dhe njih tri perspektiva të narratorit: panoramike, retrospektive dhe dramatike. Ndërkaq Buti me librin *Retorika e prozës* (1962) dalloj tipat e ndryshëm të folësve të narracionit; ndërsa Boris Uspenski me librin *Poetika e kompozicionit* (1971) duke mos dalluar autorin nga bartësi i zërit të tij, teorinë naratologjike e pasuroi me dallimin e *këndvështrimit të brendshëm* nga *këndvështimi i jashtëm*.

Këto studime shërbyen si interlud për vitin 1972 kur Zherar Zheneti, konsideronte tre tipa të fokalizimit: (1) *fokalizimin zero*; (2) *fokalizimin e brendshëm* (me nëntipat – i ndryshueshëm, i pandryshueshëm dhe fokalizimi i shumëllojshëm); dhe (3) *fokalizimin e jashtëm*. Ai dalloj edhe nocionet *alterim ose transformim* dhe dy tipa të alterimit – *paralepsën* dhe *polimodalitetin*.

Përpunimin e fokalizimit e bëri teoricientja holandeze Mike Bal, e cila ndarjen trianëtarëshe të Zhenetit e ngushtoi me dyanëtarëshin, por duke shtuar edhe të a.q. *nivel të fokalizimit*, respektivisht fokalizimin në fokalizim, ku fokalizatori¹ i nivelit të parë bëhet i fokalizuari. Në gjurmë të njëjta eci edhe Pjer Vitu. Teorinë e Mike Balit e vuri në dyshim Broncvaveri. Nga pasuesit e Mike Balit konsiderohet teoricientja izraelite Shlomit Rimon-Kenan, e cila i kthehet pikëpamjeve të Uspenskit dhe aspektin e fokalizimit e sjell në vërtetues, psikologjik dhe ideologjik. Për dallim prej saj, Simur Çetmeni bën dallimin e tregimit nga diskursi dhe të personazhit nga narratori, kurse J. Fontaneli, propozon që fokalizimi të kuptohet si njëri nga procedetë e diskurzivizimit, me ndihmën e të cilit ai që flet përjashton nga ai aktivitet dimensionin njohës të veprimtarisë vetjake të ligjërit. Gremasi niset nga lënda dhe fokalizimin e përshkruan si procedë të pandërprerë të regjistrimit koncentrik të ndonjë personazhi në rrëfim ose të ndonjë sekuence në narracion në koordinatat precize kohore – hapësinore. Ai është i mendimit se perspektivizimi i një lënde sjell pasojë të dëmshme: mjegullimin e të dytë në cilësinë e prapavisë së tij.

Morfologjia poetike e Günter Müller-it ka lënë në trashëgim tri kohë: kohën e rrëfimit, kohën e rrëfyer dhe kohën e jetës. Koha e parë është kronologjike dhe kjo është para së gjithash koha e leximit, njësitë matëse të të cilës janë ditët, orët, minutat, por matet edhe numri i

1. Me fokalizim kuptojmë "marrëdhëniet midis elementëve të pranishëm (...) të raportit midis vizionit dhe asaj që shihet". Fokalizatori, pra, është "pika nga e cila vështrohen elementet (...) dhe e cila mund të gjendet te personazhi, pra, në elementet e fabulës, ose jashtë tij". *Fokalizatori intern* (Fokalizimi i brendshëm), i cili "gjendet te ndonjë personazh", dallohet nga *fokalizatori ekstern* (Fokalizimi i jashtëm), i cili "funksionon jashtë fabulës".

fazeve, rreshtave dhe fjalëve. Analiza që përfitohet nga sasia e tekstit në ngjarje, sipas parimit të Müller – it është një informacion shumë i rëndësishëm, i cili mund të merret nga ndonjë vepër letrare.

Kohëzgjatja e subjektit formon tërësinë e veprës letrare, e cila pranë përcaktimit zhanror ka edhe përcaktimin e vet estetik, kompozicional. Kështu kompozicioni është kalimi nga pikëpamja paradigmatiske në sintagmatike. Është e ditur se veprimi foljor është i lidhur me rrjedhën kohore, e cila mund të jetë e kufizuar ose e pakufizuar. Po ashtu, ekziston i a.q. raport i jashtëm kohor i përmbajtjes foljore, i cili përcaktohet sipas pikës së momentit të ligjërit, por realizohet në kohën e tashme, të shkuar ose të ardhme. Është theksuar disa herë se roli kryesor i së tanishmes është sh[nimi i veprimit të tashmërisë dhe se me ndihmën e saj mund të sh[nohet veprimi që është zhvilluar në të kaluarën dhe veprimi që do të ngjajë në ardhmëri, dhe se në të njëjtën mënyrë, roli kryesor i të kryerës së thjeshtë është shënimi i veprimit të përjetuar, i cili në kalueshmëri ka pasur një kohëzgjatje të kufizuar dhe me ndihmën e tij mund të shprehet veprimi që do të ngjajë në ardhmëri.

Thuhet se bota e veprës letrare autonomine e vet e fiton në raport me botën reale, deri në atë masë, që të jetë në gjendje të ketë kuptim dhe të funksionojë në mënyrë të pavarur. Por, po ashtu, është thënë, se kjo botë nuk është dhe as nuk mund të jetë plotësisht e pavarur nga bota reale, bile në atë masë në të cilën kërkon formularin e vet paradigmatiske. Pikërisht për këtë kuptim është e pamundur të ndahet sistemi i kohëve foljore nga vetë fenomeni i kohës. Ndaj koha e rrëfimit mbetet kryesisht në marrëdhëniet narrator-lexues, sepse, si e ka vërejtur Paul Riccoeur, rrëfimi tregohet kurse jeta jetohet dhe se përzgjedhja i siguron rrëfimit të jetë rrëfim.

Por nëse njësi e matjes është teksti, atëherë ajo që në gramatikë quhet kohë e shkuar në veprën letrare, fiton formën e kohës së rrëfimit. Në këtë raport të dyfishtë të njëjtësisë dhe të përkufizimit midis "reales" së kohës së shkuar dhe kohës së rrëfimit, Paul Riccoeur-i sheh zbatimin e raportit të Mimesisit I dhe të Mimesisit II. Kohët e shkuara, thotë Riccoeur, tregojnë para së gjithash të kaluarën dhe pastaj me ndihmën e zhvendosjes metaforike, e cila ruan atë që tejkalon, tregojnë hyrjen në rrëfim, pa udhëzimin e drejtpërdrejtë në të kaluarën si të tillë. Shkak për këtë është tërheqja e dallimit midis autorit real dhe rrëfimtari, i cili edhe vetë është fikson. Në fikson, thotë Kete Hamburger, ekzistojnë dy diskurse, diskursi i rrëfimtari dhe diskursi i personazhit. Me të kaluar, vazhdon ajo, duhet kuptuar vetëm të kaluarën reale, të lidhur me mbamendjen ose me ndonjë relacion historik.

Në këtë kontekst realizimi poetik i *Këngës së sprasme të Balës* ndërtohet nga perspektiva e personazhit si narrator, ku perspektiva e autorit – Darës së Ri është e

fshehur. Prandaj aty përshkruhet dhe përtheksohet e kaluara e Balës, tërthorazi e kaluara krenare dhe tragjike e një dashurie të dhimbshme e fatkeqe të periudhës së Motit të Madh.

Për Barthes-in, e kryera e thjeshtë shpreh “ndërthurjen e ndërsjellë të temporalitetit dhe kauzalitetit (...) dhe kushtëzon që rrëfimi të zhvillohet në një mënyrë të shkallëzuar, d.m.th. të bëhet i kuptueshëm. Për këtë arsye ajo është mjet ideal, për çdo ngritje të botës; është kohë artificiale, kosmogoni e miteve dhe e historisë (...). Pas tij gjithmonë fshihet demiurgu, zoti ose rrëfimtari” (Barthes, 1979: 21-22).

Për Paul Ricoeur-in “dallimi midis të kryerës së tejshtuar dhe kohës së shkuar nuk ka kurrfarë lidhesh me emërtimin e rëndomtë të kohës, por (...) lidhet me aftësinë që me vetë kohën të kuptohet një aspekt i të paparashikueshmes”. Për Harld Vajnrih-un: “koha fiktive e kohës kurrë nuk është plotësisht e prerë nga koha e përjetuar, koha e mbamendjes dhe e veprimi” (Ricoeur, 1987: 396).

Gynter Mülleri, në strukturën temporale përfshin edhe kohën e jetës, kurse G. Genette kohën implicite dhe kohën tematike e konsideron fundamentale. Kështu koha e jetës, mbetet jashtë veprës letrare. Për Genette synim i analizës është: koha e rrëfimit dhe koha e diegezës, ose koha e fabulës dhe koha e subjektit.

Ngjashëm është shprehur edhe R. Barthes. Ai është i mendimit se atë që e quajmë kohë ekziston vetëm si funksion, si element i sistemit semiotik. Sipas tij, koha, në kuptimin e mirëfilltë, nuk i përket diskursit, por referencës. Analiza e tekstit narrativ, sipas tij, duhet ta dekronologjizojë kontinuitetin narrativ.

Kështu u mendua se teksti projekton lexuesin e vet ideal, por nga ana tjetër, ekziston edhe publiku konkret historik, të cilit i atribuohet teksti, në momentin dhe në vendin e paraqitjes dhe, në fund, ekziston lexuesi aktual, te i cili si të thuash teksti nuk ka llogaritur. Njëra nga kritikët poststrukturaliste mundësoi që konceptit statik të shenjës t’i jepet efekti destruktiv – faktet dhe përvojat e vetë temporalitetit. Derrida thotë se historia e veprës nuk qëndron vetëm në të kaluarën e veprës, ose në ardhmërinë e saj të paramenduar.

Çështja komplikohet me futjen e lexuesit si pjesëmarrës aktiv në kodin e komunikimit. Ai me kontekstin e vet, duke respektuar Mimesis I, fut në vepër përjetimin e vet të kohës dhe në bazë të tij të gjitha përjetimet e tjerë të kohës. Leximi është ngjarje në kohë në procesin e të cilit, si shpjegon Jaussi, ekziston një jostabilitet i caktuar, të cilin lexuesi përpigjet ta stabilizojë dhe t’i japë metatekst të ri. Gjatë leximit pandërprerë krijojmë presupozime, sepse qëndrimet e skematizuara të tekstit ofrojnë vetëm parashikimet themelore për lëndën e përshkruar.

Recepcioni i tekstit, në mënyrë simultane, “zhvillohet” në dy drejtime: nga njëra anë me rrjetën e teksteve (teksti–metateksti–(kon)teksti) dhe, nga ana tjetër me realitetin e dhënë si “masë” të krijimit të metatekstit të lexuesit në bazë të prototekstit. P. Ricoeur përkundër strukturalizmit saussurean, i cili nuk e pranon referentin (realitetin), ka vërejtur se koha e jetës është e orientuar nëpërmjet kohës së treguar në tekstin e veprës letrare. “Përjashtimi i udhëzimeve në jetë”, sipas Ricoeur-it, do të sillte që të “mos kuptojmë se tendosja midis dy kohëve buron nga një morfologji, e cila (...), i ngjet punës së arsimimit – transformimit të organizmave të gjallë, por prej tyre dallohet se jeta e pakuptimtë, me ndihmën e artit, ngritet në vepër kuptimplote” (Ricoeur 1987: 403). Barthes-i problemin e temporalitetit e studioi vetëm nga pozita e tekstit, Ricoeur nga natyra e kundërt: vetëm nga pikëpamja e Mimemis III (Lexuesit).

* * *

Pra, që të arrihet deri te ritmi global në veprën letrare ne jemi të ballafaquar fillimisht me dy përjetime të ndryshme të kohës: kohës fizike, e cila në vete nënkupton marrëdhëniet matematike-historike ndaj ngjarjeve dhe kohën psikologjike, në të cilën secili individ ka masën e tij vetjake të kohës, e cila përputhet ose jo me kohën fizike. Këto dy përjetime të kohës mund të gërshetohen, të kenë raport të ndërsjellë dhe të ndërtojnë një “dimension të ri kohor”. Kjo kohë fiktive ngritet në bazë të kohës së rrëfimit, kohës që është rrëfyer dhe kohës së jetës. Me këtë rast me kohën e rrëfimit nënkuptohet prezantimi i ngjarjeve të caktuara nëpër faqet e tekstit. Koha që rrëfëhet funksionimin e vet e fiton në raportin midis fabulës dhe subjektit, ku mund të paraqitet elipsa, pauza, skena, përmbledhja dhe ngadalësimi, të cilët me praninë e tyre në episode të veçanta të veprës letrare ndihmojnë funksionalizimin e ritmit të tërësishëm. Duke analizuar konstituentët e kohës që rrëfëhet arrihet në përfundim se secila vepër letrare, në parim, mbështetet në dy boshte kohore, të cilët midis tyre gërshetohen dhe varësisht nga tipi i veprës, midis tyre zëvendësojnë pikën dominuese: nga njëra anë është boshti historik, i cili paraqet momentin kulturor-qytetëruar, kurse nga ana tjetër është boshti psikologjik, i cili paraqet përjetimin individual të kohës. Koha e jetës i mbetet në dispozicion lexuesit dhe aktivizohet nëpërmjet kohës së narracionit me ndërmjetësimin e kohës që rrëfëhet. Ky raport midis kohës së rrëfimit dhe kohës që rrëfëhet ndriçohet në pozitën dhe rolin e narratorit: kush rrëfen, kujt i rrëfëhet, nga cila pozitë rrëfëhet dhe në ç’raport janë narratori me personazhet.

Pse është e rëndësishme analiza temporale e veprës letrare? Thjesht pse me rindërtimin e temporalitetit

të strukturës së veprës letrare mund të hapërohet në mënyrë m[cilësore në botën e interpretimit. Në pyetje është ndriçimi i ndërsjellë i marrëdhënieve të elementeve të veprës letrare, të cilët kushtëzohen ose me temporalitetin ose paraqesin boshte të ndryshme temporale, të cilët sipas natyrës së sendeve anojnë kah ndonjë tërësi rregullatore. Fjala është, natyrisht, për fabulën, vendin e subjektit, përshkrimin, dialogun, narratorin, personazhet. Në mënyrën se si analiza nuk guxon të jetë larg interpretimit, sepse kjo e dyta të parën e pasuron, marrëdhëniet e ndërsjella të kohës së rrëfimit dhe të kohës që rrëfëhet, pasurojnë kohën jetësore, e cila aktivizohet nëpërmjet kohës së treguar me ndërmjetësimin e botës që rrëfëhet. Në të tri kohëzgjatjet, përmbahet edhe analiza edhe parimi i interpretimit. Në mungesë të cilësdo prej tyre, qasja e veprës letrare, do të përfundonte ose në analizë lakuriqe, me mungesë të kuptimit, ose vetëm në interpretim, i cili në këtë rast do të mbështetej, jo në dije, por në shije.

Në poemën e Garvil Darës së Ri vrojtuam organizimin kohor, por përmendëm edhe fokalizimin. Koha në poemë është organizuar ashtu që narracioni është kryesisht prospektiv dhe në të njohim të gjitha të dhënat relevante të domosdoshme për lidhjen e fotografisë për personazhet në vepër. Megjithatë, monotonisë prospektive shkrimtari i është shmangur me "fluturimet" e kohëpakohshme retrospektive, funksioni i të cilave është në të, që përmes vetëdijes së kolektivit lexuesit, më në detaje dhe më bukur t'ia paraqesë faktet tanimë të njohura lidhur me personazhin dhe jetën e tij.

BIBLIOGRAFIA

1. Bahtin, M., (1989): *O romanu*. Beograd: Nolit. Këtë term mendohet se e ka huazuar nga Einstein – i.
2. Bal, Mike (2000): *Naratologija, teorija priče i pripovedanja*, Narodna knjiga, Beograd.
3. Bastide, F. (1997): *Fokalizacija*: Biti, V.: *Pojmovnik*: 101-102.
4. Beker, Miroslav (1986), *Suvremene knjizevne teorije*, SNL, Zagreb.
5. Benveniste, Emile (1975/1966), *Problemi opste lingvistrice*, Nolit, Beograd.
6. Biti, Vladimir (1987), *Interes pripovjednog teksta*, SNL, Zagreb.
7. Brebanovic, Predrag (1995): *Dva problema moderne teorije pripovedanja*. Numri tematik Reci 7 dhe 8, Beograd, II, nr. 9; maj: 105-113.
8. Broncvaer, W. (1988), *Pojam fokalizacije Mieke Bal*, Putevi, Banja Luka, knj. XXXIX, mart-april, str. 74-85.

9. Buló, Jorgo (1998), *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, Tiranë.
10. But, Vejn (1976): *Retorika proze*, Nolit, Beograd.
11. Cetmen, Simur (1995): *Likovi i pripovedaci*, Rec, Beograd, II, nr. 8, april: 87-94.
12. Dado, Floresha (2003), *Teoria e veprës letrare. Poetika*, Tiranë: 200-209; 210-265.
13. Dara i Riu, Gavril (1976), *Kënga e sprasme e Balës*, Prishtinë.
14. Demiraj, Shaban (1976), Gavril Dara (i Riu): Gavril Dara i Riu: *Kënga e sprasme e Balës*, Prishtinë.
15. Elsie, Robert (2001), *Historia e letërsisë shqipe*, Prishtinë: 131-132.
16. Genette, Gerard (1992), *Figures III*, Paris, 1972. – janë shfrytëzuar kapitujt e librit të përfshira në librin *Suvremena teorija pripovijedanja*, Zagreb, 1992, ur. V.Biti dhe kapitujt e përfshirë në 304-5/1984 dhe Gordogan 17-18/1985.
17. Genette, Gérard (1976/1966), *Granice price*, TEKA 6, Zagreb.
18. Greimas, A. J. (1997): *Les actants, les acteurs, et les figures*: kapitulli i përfshirë në "Revija" 2/1979; dhe *Fokalizacija*: Biti, V.: *Pojmovnik suvremene knjizevne terminologije*, MH, Zagreb, 1997: 101-102.
19. Hamburger, Käte (1976), *Logika knjizevnosti*, Nolit, Beograd.
20. Jauss, Hans Robert (1986), »Povijest knjizevnosti kao izazov znanosti«, M. Beker: *Suvremene knjizevne teorije*, Zagreb.
21. Kaller, Xhonatan (2001), *Teori letrare*. Era, Prishtinë: 91-102.
22. Kodra, Klara (1989), *Historia e letërsisë shqiptare*, Prishtinë: 294-307.
23. Kodra, Z. (1968), *Historia e letërsisë shqipe I-II*, Prishtinë: 350-376.
24. Lotman, J. M. (1976): *Struktura umjetničkog teksta*. Beograd: Nolit.
